



Komisioni i Komunitetit Evropian për llogari të dhe në emër të Qeverisë së Shqipërisë,

Ref.: EuropeAid/124909/C/SER/AL

## Zbatimi i Planit Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit Mjedisor në Shqipëri

Komponenti B: Planifikimi i Zbatimit



5 shkurt 2009

Ky raport është përgatitur nga një ekip i projekti që punon për Grontmij i Carl Bro ne kuadrin e nismes së financuar nga programi CARDS 2006 i Bashkimit Evropian. Konstatimet, përfundimet dhe interpretimet e shprehura në këtë dokument janë ekskluzivisht ato të Grontmij i Carl Bro dhe në asnjë rast nuk duhet menduar se reflektojnë opinionet dhe politikat e Komisionit Evropian.

Komisioni i Komunitetit Evropian, për llogari të dhe në emër të Qeverisë së Shqipërisë,

Ref.: EuropeAid/124909/C/SER/AL

Zbatimi i Planit Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit Mjedisor në Shqipëri

## **PLANI SPECIFIK I ZBATIMIT TË DIREKTIVËS**

### **Direktiva e Nitrave (91/676/KE)**

**Autorët:**

**Paolo Bacca, Norman Sheridan, Jonathan Pearse, Narin Panariti**

**Falenderime:**

Ekipi i projektit dëshiron të shprehë mirënjohjen të gjithë personave dhe ekspertëve nga të gjithë institucionet dhe aktorëve të përfshirë në grumbullimin e të dhënave dhe informacionit si dhe të gjithë personave dhe organeve që kanë mbështetur hartimin e këtij Raporti. Falenderime të veçanta shprehen për Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave dhe stafit të ekspertëve të saj.

## **Tabela e Lëndës**

<b>HYRJE</b>	<b>4</b>
<b>1 Përmbledhje Egzekutive</b>	<b>5</b>
<b>2 Kërkesa e Legjislacionit të BE-së</b>	<b>8</b>
2.1 Legjislacioni i mbuluar i BE-së	8
2.2 Kërkesat Direkte të Legjislacionit	9
2.3 Kërkesat Indirekte/ Implikimet	10
2.4 Lidhjet me Legjislacione të Tjera	11
<b>3 Situata aktuale</b>	<b>13</b>
3.1 Rolet & Përgjegjësitë	13
3.2 Kuadri ligjor aktual	14
3.3 Gjendja Aktuale e Zbatimit	14
3.4 Gjendja Aktuale e Investimeve	15
<b>4 Plani i Përafrimit</b>	<b>17</b>
4.1 Hyrje	17
4.2 Përqasja në lidhje me programin kohor për veprimet	17
4.3 Plani i Transpozimit	19
4.4 Plani i Zbatimit	20
<b>5 Kostot dhe Përfitimet</b>	<b>26</b>
5.1 Burimet dhe Kostot	26
5.2 Strategjia e Financimit	41
5.3 Përfitimet	45
<b>6 ANEKSET</b>	<b>47</b>
6.1 ANEKSI I: Tabela e përputhshmërisë	47
6.2 ANEKSI II: Lista e Ndërhyrjeve me Kostot	55
6.3 ANEKSI III: Tabela e Llogaritjes së Kostove të Zbatimit	57

6.4	ANEKSI IV: Çështje specifike për zbatimin e Direktivës së Nitateve në Shqipëri	61
-----	--	----

## Lista e Shkurtimeve

VGJSH	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
AK	Autoriteti Kompetent
KPMB	Kodi i Praktikës së Mirë Bujqësore
DSIP	Plani Specifik i Zbatimit të Direktivës
KE	Komuniteti Evropian ose Komisioni Evropian
ECE	Komisioni Ekonomik për Evropën
KEE	Komuniteti Ekonomik Evropian
ELPA (LPMSH)	Legjislacioni dhe Planifikimi Mjedisor në Shqipëri ( projekt)
BE	Bashkimi Evropian
PKB	Produkti Kombëtar Bruto
SIG	Sistemi i Informacionit Gjeografik
ha	Hektar
kg	Kilogram
LBU	Ligji mbi Burimet Ujore (Nr. 8093 i datës 21.3.1996, i amenduar)
MBUMK	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit
MMPAU	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave
N	azot
DN	Direktiva e Nitateve
OJF	Organizatë Jofitimprurëse
NH <sub>4</sub>	Amoniak (kimikisht i lidhur)
NO <sub>2</sub>	Nitrit
NO <sub>3</sub>	Nitrat
(N)ZP	(Nitrat) Zonë e Prekshme
KKU	Këshilli Kombëtar i Ujit
OBZHE	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
O <sub>2</sub>	Oksigjen
SC/KC	Sigurimi i cilësisë/kontrolli i cilësisë
KBL(-at)	Këshilli (at) e Basenit Lumor
PMBL	Planet e Menaxhimit të Basenit Lumor
ARM	Agjencia Rajonale Mjedimore
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
AT	Asistencë Teknike
EAT	Ekipi i Asistencës Teknike
DKU	Direktiva Kuadër për Ujin
ERRSU	Enti Rregullator i Sektorit Ujor

## HYRJE

Qeveria shqiptare ka detyrimin ligjor të pajtohet me vendimin e Bashkimit Evropian nëse dëshiron të arrijë anëtarësimin ndërsa transpozimi i legjislacionit të BE-së është një parakusht për aderim.

Dështimi për t'i dhënë fuqi ligjore Direktivës do të bëjë që Qeverisë t'i mungojë një nga objektivat e legjislacionit të Komunitetit Evropian që është ai i sigurimit në kushte të barabarta për ekonominë mbarë evropiane. Shtete të tjera Anëtare të KE-së do ta gjykonin të padrejtë nëse Shqipëria nuk do të pajtohej dhe kjo do të pengonte Shqipërinë për arritjen e anëtarësimit.

Ky raport paraqet rezultatet e vlerësimit institucional dhe administrativ ligjor të gjendjes aktuale të përafritimit ndaj Direktivës së Këshillit 91/676/KEE të datës 12 dhjetor 1991 në lidhje me mbrojtjen e ujrave nga ndotja e shkaktuar prej nitratesve nga burimet bujqësore, amenduar nga Rregullorja (KE) 1882/2003, dhe plani i përgjithshëm për të siguruar përafritim të plotë në përgatitje për aderimin e vendit në BE.

Raporti thekson boshllëqet dhe problemet/dobësitë që mund të pengojnë transpozimin dhe zbatimin efektiv të Direktivës dhe rrjedhimisht, identifikon përmirësimet e kapaciteteve që nevojiten për të siguruar zbatimin e saj efektiv dhe efikas. Raporti gjithashtu jep llogaritjet më të mira të kostove dhe përfitimeve që mund të bëhen aktualisht.

Raporti merr përsipër shqyrtimin e dokumentacionit përkatës në dispozicion, së bashku me kontakte të shumta dhe diskutime të hollësishme të zhvilluara si me Ekipin e Asistencës Teknike (EAT) dhe ndërmjet anëtarëve të EAT dhe një sërë zyrtarësh kryesorë.

Raporti ndahet në 5 seksione kryesore. Seksioni 2 jep një vështrim të shkurtër të përgjithshëm të Direktivës dhe seksioni 3 përmbledh situatën egzistuese në Shqipëri përsa i takon përafritimit të kësaj Direktive duke përfshirë një analizë të boshllqeve ligjore. Seksioni 4 diskuton mekanizmat e zbatimit dhe përcakton disa rekomandime për përfundimin e përafritimit të Direktivës. Kostot treguese të zbatimit paraqiten në Seksionin 5.

# 1 Përmbledhje Egzekutive

## **Qëllimi dhe efekti që synohet nëpërmjet zbatimit të Direktivës së Nitrateve**

### **Sfond Historik**

Janë ngritur pyetje rreth rëndësisë së përgjithshme të Direktivës së Nitrateve për Shqipërinë për dy arsye kryesore. Së pari, intensiteti i prodhimit të përgjithshëm në bujqësi në vend është mjaft i ulët. Si përdorimi mesatar i azotit dhe dendësia e gjësë së gjallë duken të jenë më të ulëta sesa kufijtë e vendosur në Direktivën e Nitrateve. Së dyti, argumentohet që rrjedhjet urbane dhe rezidenciale janë burimet kryesore të ndotjes së azotit dhe janë më problematike sesa bujqësia.

Ndërsa Direktiva nuk konsiderohet si prioritet për Shqipërinë, ajo pritet që të vendosë kufizime dhe kosto të konsiderueshme mbi sektorët bujqësor dhe paraqet sfida të mëdha për sistemet monitoruese dhe rregullatore.

### **Problemi**

Pjesa më e madhe e dispozitave të Direktivës nuk është transpozuar në Legjislacionin shqiptar dhe me përjashtim të disa përkufizimeve të parashikuara në Direktivë dhe të parashikuara nga Ligji “Mbi veterinarinë” dhe Ligjin “Mbi Mbrojtjen e Bimëve”, transpozimi ende nuk ka filluar por është parashikuar paraprakisht për vitin 2010 nëpërmjet një urdhri ministerial dhe qeveritar.

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave së bashku me Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministrinë e Shëndetësisë, është përgjegjëse për identifikimin e ujrave të prekura nga ndotja dhe përcaktimi i zonave të prekshme nga nitrati por nuk është marrë asnjë vendim në këtë drejtim. Nitratet nuk monitorohen megjithëse ka kontrole të rregullta të përmbajtjes kimike në ujrat e ëmbla dhe ujrat tokësore.

Për më tepër, Ministria e Bujqësisë nuk ka marrë ende hapat e nevojshme për hartimin e një plani veprimi që synon zvogëlimin e ndotjes nga nitratet.

## Plani për përafrimin

Plani i transpozimit ligjor përfshin disa rregullime/amendime në LBU (ose prezantimin e detyrimeve që mungojnë, ose riformulimin e dispozitave egzistuese që nuk janë plotësisht në përputhje me dispozitën përkatëse të Direktivës dhe dispozitat e shprehura të bazës ligjore) si dhe përgatitjen e legjislacionit dytësor, duke përfshirë :

- Rishikimin dhe nëse është e nevojshme, ripunimin e ndonjë legjislacioni përkatës 'bujqësor' për të siguruar që nuk është i papajtueshëm me Direktivën dhe me LBU të amenduar;
- Përgatitjen e një Rregulloreje mbi Ndotjen e Azotit nga Burimet Bujqësore sipas LBU-së të amenduar që do të transpozojë pjesë të ndara të Direktivës;
- Përgatitjen e një Kodi ose Kodeve të Praktikës së Mirë Bujqësore.

Plani i zbatimit përbëhet nga një sërë veprimesh që janë konsoliduar në katër grupe kryesore të veprimeve të zbatimit si më poshtë:

1. Forcimi institucional dhe ndërtimi i kapaciteteve
  - *Caktimi i një Autoriteti Kompetent*
  - *Forcimi i kapacitetit laboratorik*
  - *Sigurimi i ndihmës teknike për të ndihmuar AK të krijojë dhe ndërmarrë aktivitete fillestare dhe raundin e parë të programeve të veprimit*
2. Puna përgatitore dhe formulimi i programeve të veprimit
  - *Identifikimi i ujrave që nëse nuk do merren masa, do preken ose mund të prekeshin nga ndotja ose eutrofikimi i azotit*
  - *Përcaktimi i zonave të prekshme*
  - *Krijimi i programeve të veprimit për zonën (at) e prekshme*
  - *Rritja e ndërgjegjësimit, shpërndarja e informacionit, konsulenca dhe pjesëmarrja*
3. Monitorimi, trajtimi i të dhënave dhe raportimi
  - *Krijimi i programeve monitoruese për të: a) vlerësuar nitratat në ujrat sipërfaqësore dhe tokësore, b) rishikuar gjendjen eutrofike të ujrave të ëmbla sipërfaqësore, ujrat e grykëderdhjeve të gjera dhe ujrat bregdetare, dhe c) vlerësuar efektivitetin e programeve të veprimit*
4. Zbatimi i programeve të veprimit dhe detyrimit

## Kostot

Kostot e transpozimit të Direktivës së Nitrates në ligjin kombëtar dhe zbatimi i tyre u llogaritën veçmas. Të gjitha kostot llogariten në çmimet kostante të vitit 2008. Për sa i përket transpozimit, për shkak të burimeve të kufizuara të draftimit ligjor pranë MMPAU, rekomandohet që të sigurohet mbështetje për ekipin ligjor në përafrimin e legjislacionit shqiptar sipas nevojës (duke përfshirë hartimin e një kodi të praktikës së mirë bujqësore). Kostoja e llogaritur e asistencës teknike të nevojshme për këtë qëllim do të jetë 800,000 Euro. Kostot e llogaritura të zbatimit janë:

- Në lidhje me detyrat e qeverisë qendrore: kostot specifike prej 1.6 milionë € dhe kostot e vazhdueshme periodike prej 53,000 € në vit. Mbi 95% e kostove të përgjithshme unike argumentohen nga asistenca teknike dhe duhet të mundësohet mbulimi i këtyre kostove nga grantet e BE-së dhe donatorëve të tjerë



ndërkombëtarë. Kostot periodike kanë lidhje me krijimin e infrastrukturës administrative në ministritë e mjedisit dhe bujqësisë dhe do të duhet të financohen nga buxheti i shtetit;

- Disa kosto do të përballohen nga fermat që kërkohen të marrin masa për të shkurtuar humbjet e azotit të tyre. Këto kosto priten të jenë pak më të ulta sesa në shumë vende të tjera anëtare për shkak të intensitetit të ulët të bujqësisë shqiptare dhe nivelet e qarta relativisht të ulta të nitratit në mjedis. Një kosto e përgjithshme e kapitalit midis 300,000 Euro dhe 1,300,000 Euro që bie mbi fermat me të paktën 10 'njësi kafshë' është një llogaritje e parë e përafërt e kostove. Ndërsa njohuria për problemin rritet si rezultat i detyrave të hershme diagnostike të implementimit, do të mundësohet një llogaritje më e saktë.

## 2 Kërkesa e Legjislacionit të BE-së

Për shkak të problemeve mjedisore dhe shëndetësore mbi përqëndrimet në rritje të nitratis në ujrat sipërfaqësore dhe tokësore në BE, veçanërisht në zonat bujqësore me ferma të zhvilluara, në 1991 Këshilli i Ministrave miratoi një Direktivë mbi mbrojtjen e ujit nga ndotja e shkaktuar prej nitrates nga burimet bujqësore (Direktiva e Nitratesve, 91/676/KEE).

Objektivi i Direktivës së Nitratesve (Direktiva 91/676/KEE) është të zvogëlojë ndotjen e ujrave (përfshirë ujrat tokësore) të shkaktuar ose nxitur nga nitratis prej burimeve bujqësore dhe të parandalojë këtë ndotje të mëtejshme.

### 2.1 Legjislacioni i Mbuluar i BE-së

Legjislacioni i mbuluar i BE-së në këtë plan zbatimi është:

- Direktiva 91/676/KEE, në lidhje me mbrojtjen e ujrave nga ndotja e shkaktuar prej nitrates nga burimet bujqësore, amenduar nga Rregullorja (KE) 1882/2003.

Objektivat e Direktivës janë zvogëlimi i ndotjes së ujrave të shkaktuar ose nxitur nga nitratis nga burimet bujqësore dhe parandalimi i ndotjes së mëtejshme të këtij tipi.

Zbatimi i Direktivës së Nitratesve vijon si më poshtë: identifikimi i ujrave të prekura nga kjo ndotje dhe ujrat që mund të prekshin nga kjo ndotje dhe përcaktimi i tyre dhe i të gjithë zonave të njohura të drenazuara në ato ujra dhe që kontribuojnë në ndotje si “zona të prekshme”. Për këto zona, duhet të krijohen dhe implementohen programe veprimi për zvogëlimin e ndotjes. Këto programe veprimi përmbajnë masa të detyrueshme, përfshirë sasinë maksimale të plehut organik që mund të përdoren për tokën çdo vit, ndalimin e përdorimit të disa tipeve plehëruesish në disa periudha të vitit dhe kërkesat për enë mbajtëse për plehun e bagëtive. Për zonat jashtë zonave të prekshme, zvogëlimi i ndotjes duhet të nxitet nga kodet (vullnetare) të praktikës së mirë bujqësore. Në këtë kontekst, Shtetet Anëtare janë të detyruara të monitorojnë përqëndrimet e nitratis në ujrat tokësore dhe ujrat sipërfaqësore si dhe të monitorojnë eutrofikimin në ujrat sipërfaqësore. Shtetet Anëtare duhet të rishikojnë gjithashtu dhe nëse është e nevojshme, të ripunojnë ose bëjnë shtesa në përcaktimin e zonave të prekshme.

## 2.2 Kërkesat e Drejtpërdrejta të Legjislacionit

Direktiva vendos detyrimet e mëposhtme mbi Shtetet Anëtare:

➤ Të identifikojnë, bazuar në monitorimin e plotë gjatë një periudhe një vjeçare ( Neni 6(1) (a)), të ujrave që preken ose mund të preken nga ndotja e shkaktuar prej burimeve bujqësore ( Neni 3 dhe Aneksi I). Ujrat e ndotura përkufizohen sipas kriterëve të mëposhtme:

- Ujrat e ëmbla sipërfaqësore dhe tokësore me përmbajtje nitrati më të madhe se 50mg/l, dhe
- Liqenet natyrore me ujra të ëmbla, masa të tjera të ujrave të ëmbla, grykëderdhje të gjera, ujra bregdetare dhe ujra detare që janë eutrofike.

Këto kriterë zbatohen për të gjithë ujrat. Vlerësimi zbatohet për të gjithë ujrat, jo vetëm për ata të përdorur aktualisht për abstragimin e ujit të pijshëm;

➤ Të përcaktojnë si 'zona të prekshme' të gjitha zonat e njohura të tokës në territorin kombëtar që drenazhohen në ujrat e identifikuar dhe që kontribuojnë në ndotje sipas kriterëve të mësipërme. Megjithatë, ky përcaktim i zonave të prekshme nuk është i nevojshëm nëse programet e veprimit (sipas Nenit 5) implementohen në të gjithë territorin. Duhet të kryhet një rishikim çdo katër vjet për të ripunuar ose bërë shtesa në listën e zonave të prekshme, nëse është e nevojshme. (Neni 3);

➤ Me synim sigurimin e një niveli të përgjithshëm të mbrojtjes për të gjithë ujrat, të krijojnë një kod (ose kode) të praktikës së mirë bujqësore (Aneksi II). Ky kod duhet të implementohet vullnetarisht nga fermerët. Mund të hartohen programe për trajnimin dhe informimin e fermerëve dhe promovimin e kodit (Neni 4 dhe Aneksi IIA);

➤ Të krijojnë dhe implementojnë Programe Veprimi, ose në lidhje me zonat e prekshme të përcaktuara, ose në të gjithë territorin. Një program veprimi mund të zbatohet për të gjithë territorin ose mund të krijohen programe veprimi për zona të ndryshme të prekshme ose pjesë të zonave. Direktiva deklaron se Programet e Veprimit duhet të përfshijnë masa në kodin e praktikës së mirë bujqësore dhe për më tepër, rregulla në lidhje me:

- Periudha gjatë të cilave ndalohet aplikimi i disa tipeve plehëruesish.
- Kapaciteti i enëve mbajtëse për plehun e bagëtive që “ duhet të tejkalojë kapacitetin e kërkuar për mbajtje gjatë periudhës më të gjatë kur ndalohet aplikimi në tokë në zonat e prekshme”, nëse nuk tregohet se tejkalmi do të eliminohet në mënyrë që të mos jetë i dëmshëm për mjedisin.
- Kufizime mbi aplikimin e plehëruesve, në pajtim me praktikën e mirë bujqësore dhe duke marrë parasysh: kushtet e tokës, tipin, pjerrësinë e tokës; kushtet klimaterike, reshjet dhe ujitjen; dhe përdorimin e tokës dhe praktikat bujqësore. Duhet të ketë një ekuilibër midis kërkesës për azot të të korrave dhe furnizimit me azot nga toka dhe plehërimi.

- Sasia e plehut të bagëtive e aplikuar në tokë çdo vit, që nuk duhet të tejkalojë 210 kg azot për hektar (N/ha) gjatë Programit të Veprimit të parë katër vjeçar dhe 170 kg N/ha më pas (Aneksi III).
  - Direktiva gjithashtu udhëzon Shtetet Anëtare të marrin çdo masë të mëtijshme të nevojshme për të arritur objektivin e saj për zvogëlimin e ndotjes së ujrave nga nitratet prej burimeve bujqësore. Ajo deklaron: “Në përzgjedhjen e këtyre masave ose veprimeve, Shtetet Anëtare do të marrin parasysh efektivitetin dhe koston e tyre në lidhje me masa të tjera të mundshme parandaluese” (Neni 5(5)).
- Monitorimi i cilësisë së ujit për të cilin dallohen dy lloje të ndryshme monitorimi (Nenet 5 dhe 6):
- Në shkallë kombëtare kur Programet e detyrueshme të Veprimit janë implementuar në përputhje me Nenin 3.5, monitorimi kërkohet për ujrat sipërfaqësore dhe tokësore, për të krijuar shkallën e ndotjes së ujit nga azoti nga burimet bujqësore (Neni 5(6)), dhe
  - Mbi zonat individuale të prekshme të caktuara kur gjendja eutrofike e ujrave të ëmbla sipërfaqësore të rrjedhshme ose të ndenjura dhe përqëndrimi i azotit duhet të monitorohen të paktën çdo katër vjet (Neni 6(1)(b)).
- Të monitorojnë efektivitetin e Programeve të Veprimit që janë krijuar (Neni 6(5)).
- Detyrimet raportuese për Komisionin.
- Të krijojë sistemin e raportimit dhe regjistrimit të të dhënave, në veçanti Autoritetit Kompetent i kërkohet t'i raportojë Komisionit në lidhje me:
    - Përcaktimin e zonave të prekshme (Neni 3),
    - Kodet e praktikës së mirë bujqësore (Neni 4),
    - Ndryshimet e bëra në Programet e Veprimit (Neni 5),
    - Raportin mbi zbatimin e Direktivës çdo katër vjet (Neni 10 dhe Aneksi V),
    - Transpozimin me tekstet e dispozitave të ligjit kombëtar të miratuar në këtë fushë, të mbuluar nga Direktiva (Neni 12).

### 2.3 Kërkesa jo të drejtpërdrejta/ Implikime

Kërkesat jo të drejtpërdrejta dhe implikimet e Direktivës janë:

- Kërkesat e Direktivës së Abstragimit të Ujit të Pijshëm (75/440/KEE) në lidhje me cilësinë e kërkuar të ujit sipërfaqësor të synuar për abstragimin e ujit të pijshëm dhe Direktivës mbi Ujrat Tokësore (80/68/KEE) mbi mbrojtjen e ujrave tokësore nga ndotja e shkaktuar prej disa substancave të rrezikshme, me qëllim që të rrisin cilësinë e ujrave tokësore dhe sipërfaqësore dhe për këtë rast të përgatisin një plan sistematik duke përfshirë oraret, do të duhet të implementohen paralelisht me Direktivën.
- Planet e Menaxhimit dhe Programet e Veprimit të Zonës së Prekshme do të duhet të shqyrtohen së bashku me Direktivën e Trajtimit të Ujrave të Mbetura Urbane (91/271/KEE), gjatë zbatimit të Direktivës.

- Duke zbatuar përfaqshjen e kombinuar për burimet e pikave dhe shpërndarjes së ndotjes, Direktiva Kuadër mbi Ujin, konkretisht (Neni 10) kërkon që në lidhje me ndikimet e shpërndarjes, duhet të implementohen praktikatat më të mira mjedisore. Kjo përfshin masat e marra sipas Direktivës së Nitrateve. Për më tepër, masat bazë që duhet të përfshihen dhe merren minimalisht brenda programit të masave (Neni 11) të vendosura për secilin Distrikt Baseni Lumor duhet të përfshijnë masat e marra për të zbatuar Direktivën e Nitrateve. Për më tepër, “zonat e prekshme” të identifikuar sipas Direktivës së Nitrateve përfshihen në listën e “zonave të mbrojtura” në Aneksin IV të DKU-së.

## 2.4 Lidhjet me Legjislacione të Tjera

### Lidhjet me legjislacione të tjera brenda sektorit të cilësisë së ujit:

- Direktiva e Këshillit 75/440/KEE e datës 16 qershor 1975 në lidhje me cilësinë e kërkuar të ujrave sipërfaqësore të synuara për abstragimin e ujit të pijshëm;
- Direktiva e Këshillit 80/68/KEE e datës 17 dhjetor 1979 mbi mbrojtjen e ujrave tokësore nga ndotja e shkaktuar prej disa substancave të rrezikshme;
- Direktiva e Këshillit 91/271/KEE e datës 21 maj 1991 në lidhje me trajtimin e mbetjeve të ujrave urbane;
- Direktiva e Këshillit 79/869/KEE e datës 9 tetor 1979 në lidhje me metodat e matjes dhe shpeshhtësisë së marrjes së mostrave dhe analizën e ujrave sipërfaqësore të synuara për abstragimin e ujit të pijshëm në Shtetet Anëtare;
- Parlamenti Evropian dhe Direktiva e Këshillit 2000/60/EC e datës 23 tetor 2000 që krijon një kuadër për Veprimin e Komunitetit në fushën e Politikës Ujore.
- Direktiva e Këshillit 98/83/KE e datës 11 nëntor 1998 mbi cilësinë e ujit të synuar për konsum njerëzor.

### Lidhje me Legjislacione të Tjera brenda sektorëve të tjerë:

- Direktiva Kuadër e Rishikuar e Mbetjeve (2008/98/KE)<sup>1</sup>;
- Direktiva mbi Derdhjet e Ujrave të Zeza (86/278/KEE);
- Direktiva Raportuese (91/692/KEE) dhe Vendimi i amendimit 94/741/KEE;
- Direktiva mbi Kontrollin dhe Parandalimin e Integruar të Ndotjes (KPIN) (96/61/KE);

<sup>1</sup> Direktiva Kuadër e Rishikuar e Mbetjeve (2008/98/KE) u nënshkrua në emër të Parlamentit Evropian dhe Këshillit në 19 nëntor 2008 dhe është botuar në Fletoren Zyrtare (FZ) të Bashkimit Evropian L312/3.

Direktiva e Re qartëson dhe arsyeton legjislacionin e BE-së mbi mbetjet dhe zëvendëson Direktivën Kudër Egzistuese të Mbetjeve, Direktivën mbi Mbetjet e Rrezikshme dhe Direktivën e Mbetjeve të Naftës.

Ajo qartëson kuptimin e termit 'mbetje' dhe ato të koncepteve të tjera si 'riciklim' dhe 'rigjenerim'. Ajo aplikon një hirearki të re për mbetjet, zgjeron parimin “ ndotësi paguan” duke theksuar përgjegjësinë e prodhuesit, zbaton objektivat e menaxhimit të mbetjeve dhe të zvogëlimit më të rreptë të mbetjeve për Shtetet Anëtare dhe kërkon përmirajtje të përmirësuar në planet e menaxhimit të mbetjeve.

- Direktiva mbi Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor (VNM) (85/337/KEE) e amenduar nga Direktiva 97/11/KE dhe Direktiva 2003/35/KE.

### 3 Situata aktuale

Në përgjithësi, Shqipëria po përparon drejt përafrimit gradual të ligjeve të saj me legjislacionin mjedisor të Bashkimit Evropian dhe synon të përmbushë procesin e përafrimit të tij brenda një kuadri kohor të arsyeshëm. Megjithatë, nga pikëpamja praktike, e meta kryesore e legjislacionit aktual ka qënë zbatimi i tij i kufizuar deri tani për shkak të burimeve të pamjaftueshme.

Në këtë kontekst, është e rëndësishme të vërejmë se derisa të sigurohen burime të mjaftueshme për implementimin dhe zbatimin e legjislacionit, ky transpozim që mund të bëhet gjatë viteve në vazhdim do të kontribuojë në njëfarë mënyre në procesin e përgjithshëm të përafrimit.

Me përjashtim të përkufizimeve bazë, Direktiva e Nitateve duhet të transpozohet ende dhe nuk është e lehtë të shohim sesi ajo mund të transpozohet mbi bazën e legjislacionit egzistues që është mjaft i ngushtë për ta arritur këtë.

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave së bashku me Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministrinë e Shëndetësisë, është përgjegjëse për identifikimin e ujrave të prekura nga ndotja dhe përcaktimi i zonave të prekshme, por nuk është marrë asnjë vendim në këtë drejtim. Nitratet nuk monitorohen megjithëse ka kontrolle të rregullta të përmbajtjes kimike në ujrata e ëmbla dhe tokësore.

Për më tepër, Ministria e Bujqësisë nuk ka marrë ende hapa të nevojshme për hartimin e një plani veprimi që synon zvogëlimin e ndotjes së nitateve.

#### 3.1 Rolet & Përgjegjësitë

Në nivel qëndror rolet kryesore në lidhje me Direktivën do të luhen nga Ministrinë e mëposhtme:

### **Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave**

MMPAU ka disa kompetenca në lidhje me menaxhimin e burimeve të ujrave, veçanërisht në lidhje me ndotjen e ujrave, lejet për shkarkimet e ujrave dhe monitorimin e ujrave<sup>2</sup>.

MMPAU është përgjegjëse për përcaktimin e zonave të prekshme.

### **Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit**

Kjo Ministri është përgjegjëse për një nga sektorët kryesorë të përdorimit të ujit, domethënë ujitja për bujqësi.

Ministria, në bashkëpunim me Qendrën e Transferimit të Teknologjive të Bujqësisë ( Departamenti Përdorimit të Tokës dhe Ujit) pritet të hartojë një Ligj mbi “ Kontrollin e përdorimit të plehëruesve”. Ligji duhet të prezantojë kodet e praktikës së mirë bujqësore për t’i dhënë të gjitha ujrave një nivel të përgjithshëm të mbrojtjes nga ndotja.

## **3.2 Kuadri ligjor aktual**

Ligji Nr. 8093 datë 21.3.1996 ‘Mbi Burimet Ujore<sup>3</sup>’ (amenduar nga Ligji 8375 i datës 15.7.1998, Ligji 8605 i datës 20.4.2000, dhe Ligji 8736 i datës 01.2.2001) transponon të gjitha përkufizimet e Direktivës.

Specifikisht, përkufizimet e mëposhtme të Direktivës mund të konsiderohen të transpozuar: Neni 2 (a), (c), (i), (j) dhe (k). Megjithatë, duhet të vërehet se ndotja (Neni 2(j)) përkufizohet gjerësisht në legjislacionin kombëtar dhe nuk mbulon specifikisht ndotjen nga nitrati. Me përjashtim të këtyre përkufizimeve, transpozimi nuk ka filluar ende por parashikohet nëpërmjet një urdhri ministerial dhe qeveritar të parashikuar paraprakisht për vitin 2010.

## **3.3 Gjendja aktuale e Zbatimit**

### **3.3.1 Legjislacioni**

Dispozitat e Direktivës nuk janë transpozuar në Legjislacionin Shqiptar ( disa prej dispozitave të parashikuara në Direktivë: bagëtitë dhe plehëruesit parashikohen nga Ligji “Mbi veterinarinë” dhe Ligji “Mbi Mbrojtjen e Bimëve”, por ato kanë lidhje me Bujqësinë dhe Shëndetin e Kafshëve.

Në projektligjin (e përgatitur nga Projekti ELPA) që amendon Ligjin mbi Burimet Ujore (LBU), Neni 26/2 deklaron: “*Brenda 2 vitesh nga hyrja në fuqi e Rregullores së miratuar në përputhje me kërkesat e Nenit 1(drafti i ri), Këshilli Kombëtar i Ujit, me propozimin e përbashkët të Ministrit (të Mjedisit) dhe Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, do të mbështesë rregullat e hollësishme në lidhje me përdorimin e plehërizesve*

---

<sup>2</sup> Aktualisht, shërbimet e monitorimit të ujit kryhen nga Institutet Shkencore nëpërmjet kontratave me MMPAU.: Këto janë: Instituti i Hidrometeorologjisë (cilësia dhe sasia e ujit sipërfaqësor), Instituti i Vëzhgimit Gjeologjik (cilësia e ujrave tokësore ), dhe Instituti i Mjedisit (shkarkimet e ujrave të mbetura).

<sup>3</sup> Gjithashtu, quajtur ndryshe Ligji mbi Burimet Ujore dhe Ligji mbi Rezervat Ujore



*brenda zonave të pambrojtura, me qëllim që të mbrojnë nga ndotja ujin që drenazhohet në këtë zonë”.*

Projektligji mbi Burimet Ujore është marrë gjithashtu në konsideratë në këtë vlerësim- ndryshe nga një përkufizim i ujrave tokësore që paraqitet në Draftin LBU, Direktiva e Nitrateve nuk është transpozuar. Megjithatë, Drafti LBU, neni 26C, Ndotja nga Burimet Bujqësore, krijon bazën ligjore për transpozimin e Direktivës: Këshilli Kombëtar i Ujit duhet të botojë një Rregullore që kërkon që të gjithë Këshillet e Baseneve Lumore të identifikojnë ujrat që janë prekur ose mund të prekeshin nga ndotja prej burimeve bujqësore dhe të përcaktojnë ‘zonat e prekshme. Për më tepër, KKU duhet të miratojë rregulla në lidhje me përdorimin e plehëruesve në zonat e prekshme.

Për të përmbushur këtë kërkesë, do të jetë e nevojshme të hartohet një rregullore (akt normativ) që miraton Direktivën 91/676/KEE në lidhje me mbrojtjen e ujrave nga ndotja prej nitrateve nga burimet bujqësore.

### **3.3.2 Masat Institucionale**

MMPAU, së bashku me Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministrinë e Shëndetësisë, do të jetë përgjegjëse për identifikimin e ujrave të prekura nga ndotja dhe përcaktimin e zonave të prekshme, por nuk është marrë asnjë vendim në këtë drejtim. Nitratet nuk monitorohen megjithëse ka kontrole të rregullta të përmbajtjes kimike në ujrat e ëmbla dhe tokësore.

Për më tepër, Ministria e Bujqësisë nuk ka marrë ende hapat e nevojshme për hartimin e një plani veprimi që synon zvogëlimin e ndotjes së nitrateve.

## **3.4 Gjendja Aktuale e Investimit**

Me qëllim zbatimin e Direktivës, kërkohen tipet e mëposhtme të investimeve:

- Investim në personel;
- Investim në trajnimin e nevojshëm dhe ndërtimin e kapaciteteve;
- Investim në kapacitetin monitorues të cilësisë së ujit dhe ujrave tokësore, duke përfshirë pajisjet joautomatike që duhet të përdoren nga inspektorët në terren;
- Investim në kapacitetin e përshtatshëm laboratorik;
- Investim në masat konkrete teknike për të parandaluar shkarkimin e përbërësve të azotit në ujrat sipërfaqësore.

### *Investim në personel*

Aktualisht, nuk ka persona në stafin e MMPAU që merren me çështjet e mbuluara nga Direktiva, dmth ndotjen nga azoti të ujit dhe rolin e bujqësisë dhe sektorëve të tjerë në këtë ndotje.

Inspektorati i Plehëruesve Kimikë i MBUMK (në Fushe-Kruje) ka 3 specialistë që angazhohen me nitratet si me të gjitha llojet e tjera të plehëruesve. MBUMK ka një Drejtorin për Prodhimin e Bimëve dhe një

Sektor për Mbrojtjen e Bimëve. Midis të tjerash, ata mbulojnë plehëruesit dhe nitratat por asnjë anëtar i stafit të tyre nuk angazhohet specifikisht me nitratat.

#### Ndërtimi i kapaciteteve dhe trajnimi

Ka patur një numër të madh projektesh për asistencën teknike dhe projekte të tjera të kryera në sektorin e ujit gjatë viteve të fundit, veçanërisht në lidhje me furnizimin me ujë, kanalizimet dhe monitorimin e ujit. Megjithatë, asnjë projek AT nuk ka shqyrtuar specifikisht çështjet e trajtuara nga Direktiva.

#### Monitorimi i cilësisë së ujit

Programet monitoruese aktuale mbi lumenjtë kombëtarë në Shqipëri janë relativisht gjithëpërfshirëse dhe përfshijnë shumë nga zonat e ndotura dhe “zonat e nxehta” mjedisore. Karakteristikat fiziko-kimike matur në stacionet e përzgjedhura monitoruese nga Instituti i Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (ish Instituti i Hidrometeorologjisë) zakonisht kufizohen në parametrat kryesore të lëndëve ushqyese dhe cilësinë e ujit me matjen e kufizuar të metaleve të rënda, lëndëve organike dhe substancave të përzgjedhura prioritare.

Vëzhgimi Gjeologjik Shqiptar (VGJSH) është institucioni kryesor përgjegjës për hetimet e ujrave tokësore. Matjet e cilësisë së ujit përfshijnë përqëndrimet e  $\text{NH}_4$ ,  $\text{NO}_2$ ,  $\text{NO}_3$  dhe  $\text{O}_2$  në mostrat e ujit të mbledhura dy herë në vit. Aktualisht dhe VGJSH kryen monitorimin e ujrave tokësore në 8 shtresa ujëmbajtëse kryesore prodhimi. Rrjeti monitorues aktual i cilësisë së ujit tokësor përbëhet nga 32 puse prodhimi të instaluar në shtresat ujëmbajtëse çerekëshe (zhavorr).

VGJSH ka përgatitur dhe paraqitur pranë MMPAU disa propozime projektesh mbi monitorimin e ujit tokësor që mbulon të gjithë vendin dhe të gjithë ujin tokësor të shtresëzuar (shtresat ujëmbajtëse poroze, karbonike, molasik dhe magmatike), por për shkak të financave, këto projekte nuk janë implementuar.

#### Laboratoret

Laboratoret e operuara nga Shërbimi Hidrometeorologjik janë të afta të kryejnë matjet e kërkuara të azotit në mostrat e ujit por nuk janë të akredituara dhe aktualisht nuk kanë në dispozicion procedurat e duhura SC/KC të parashikuara në legjislacionin e BE-së.

#### Masat teknike

Nuk është marrë asnjë masë e rëndësishme për të zvogëluar ndotjen e ujrave sipërfaqësore nga lëndët ushqyese me bazë azoti dhe lëndët e tjera ushqyese.

## **4 Plani i Përafrimit**

### **4.1 Hyrje**

Me nënshkrimin në 12<sup>th</sup> prill 2006 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) me Komunitetin Evropian dhe Shtetet e tjera Anëtare, Shqipëria ka konfirmuar fuqimisht angazhimin e saj politik tashmë të shprehur qartë për anëtarësimin në BE.

Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA-së 2007 - 2012, miratuar nga Këshilli i Ministrave në 5<sup>th</sup> korrik 2006, në një shkallë të caktuar ofron një konfirmim të përkushtimit të të gjithë institucioneve përkatëse dhe nëpunësve civilë për t'iu përgjigjur kërkesave të procesit të integritimit në BE.

Një nga kushtet kryesore për anëtarësimin në BE është integrimi dhe zbatimi i legjislacionit të BE-së, të ashtuquajturit proces përafrimi që përbëhet prej tre komponentëve kryesorë: transpozimi ligjor, zbatimit dhe detyrimit.

Plani i përgjithshëm për të arritur përafrimin e plotë paraqitet në paragrafët e mëposhtëm. Ai përbëhet nga një plan transpozimi ligjor dhe një plan zbatimi (pershire dhe detyrimin).

*Plani i transpozimit ligjor* përfshin disa rregullime/amendime në LBU (ose prezantimin e detyrimeve që mungojnë, ose riformulimin e dispozitave egzistuese që nuk janë tërësisht në përputhje me dispozitën përkatëse të Direktivës dhe dispozitat e qarta të bazës ligjore) si dhe përgatitjen e një legjislacioni dytësor. Një përshkrim i hollësishëm i planit të transpozimit ligjor paraqitet në paragrafin 4.3.

Plani i zbatimit përbëhet nga një sërë veprimesh që konsolidohen në katër grupe kryesore të veprimeve të zbatimit (referojuni më poshtë Tabelës 2). Një përshkrim i hollësishëm i planit të zbatimit paraqitet në paragrafin 4.4.

### **4.2 Përqasja në lidhje me programin kohor për veprimet**

Përgatitja e planit të zbatimit të Direktivës nënkupton hartimin e një programi kohor për veprimet. Përcaktimi i këtij programi kohor nuk është

një çështje e thjeshtë dhe varet (midis të tjerash) nga faktorët dhe kriteret e mëposhtme:

1. Minimalisht, legjislacioni duhet të ishte transpozuar në ligjin kombëtar deri në datën e aderimit në BE. Parimisht, ai duhet të ishte implementuar në shkallë të gjerë. Ndërsa ishte i mundur negociimi i disa periudhave të përkohshme, dmth periudhat e shtyrjes së afatit pas datës të aderimit për të arritur pajtueshmëri, këto periudha të përkohshme normalisht jepen vetëm për një numër të kufizuar të direktivave 'me kosto të lartë' dhe më pas vetëm për detyrimet specifike të përmendura sipas këtyre direktivave. Megjithëse zbatimi i Direktivës së Nitrateve mund të vendosë kosto të konsiderueshme mbi fermerët, Komisioni Evropian është treguar i gatshëm për të dhënë periudha tranzicioni sipas kësaj Direktive, duke preferuar një përjasje me anë të së cilës, nëse është e nevojshme, masat më të kushtueshme në programet e veprimit ndahen në faza gradualisht nga koha e aderimit (për shembull në aderimin e Polonisë, Lituanisë). BE e ka bërë të qartë që e konsideron zbatimin e Direktivës së Nitrateve një detyrë me prioritet të lartë. Data e aderimit të Shqipërisë nuk është caktuar ende por është pranuar gjerësisht që kjo nuk mund të jetë para vitit 2015.
2. Përafrimi përfshin kosto të papërbalueshme (ndoshta disa miliarda Euro vetëm për legjislacionin mjedisor). Sa më e gjatë të jetë periudha për të cilën planifikohet përafrimi (në bazë të pikës (1) më lart), aq më e lartë do të jetë barra e kostos dhe tarifa mbi disa burime të kufizuara (për shembull koha e avokatëve pranë qeverisë qëndrore, në dispozicion për draftimin ligjor). Përveç kostove të shpërndara me anë të caktimit të një programi më të zgjatur kohor, kostot e përgjithshme nganjëherë ulen aktualisht (kjo aplikohet veçanërisht në rastin e investimeve nga ndërmarrjet industriale ose bujqësore, kur shtyrja e një detyrimi investimi mund ta lejojë të harmonizohet me plane të tjera investimit, për efikasitet më të lartë).
3. 'Prioriteti' i masës. Për shembull, megjithëse transpozimi i Direktivës së Nitrateve konsiderohet nga Komisioni Evropian si prioritet i lartë, shtetet aderuese në të kaluarën nuk priteshin të kërkonin programe investimi të konsiderueshëm deri pas aderimit<sup>4</sup>.
4. Faza e një veprimi ose aktiviteti zbatimi të veçantë varet shpesh nga veprime të tjera që lidhen ose me të njëjtën direktivë, ose nganjëherë me ndonjë legjislacion tjetër.

Caktimi i një programi kohor për rrjedhojë përfshin gjetjen e ekuilibrit të duhur midis ndarjes në faza të veprimeve në mënyrë që kostot dhe burimet

---

<sup>4</sup> Shih për shembull: Qëndrimi i Përbashkët i BE-së (CONF-LT 54/00) i paraqitur në Konferencën mbi Aderimin në Bashkimin Evropian në 15 nëntor 2000: "Në lidhje me Direktivën 91/676/KEE mbi ndotjen e nitrateve nga burimet bujqësore, BE përkrah vendimin e Lituanisë për të tërhequr kërkesën e saj për një periudhë të përkohshme dhe që është gati për të hartuar një program veprimi në 2003 dhe të fillojë zbatimin e tij deri në datën e aderimit . ....."

e pamjaftueshme të mos tejkalohen ndërsa tregojnë progres të mjaftueshëm për në BE dhe për përmbushjen e afateve të nevojshme të pajtueshme me aderimin në kohë të Shqipërisë për në Bashkimin Evropian.

Në përcaktimin e ndarjes së fazave gjatë kohës së veprimeve të përafrimit, përqsja e ndjekur kishte qënë të specifikonte vitet përkatëse (që fillojnë me vitin 0), bazuar në një program kohor të përshtatshëm minimal por duke mos marrë parasysh kufizimet e burimeve. Në praktikë, ritmi me të cilin këto direktiva/rregullore mund të transpozohen dhe implementohen do të varet nga disponueshmëria e burimeve të pamjaftueshme të fuqisë punëtore dhe buxheteve që duhet të ndahen me sektorë të tjerë mjedisorë<sup>5</sup>. Kufizimet e burimeve nuk mund të aplikohen veçmas për ndonjë plan zbatimi direktive specifike. Kur planet e zbatimit hartohen për të gjitha direktivat që duhet të trajtohen në këtë projekt, pasqyra e përgjithshme e kostos mund të vlerësohet dhe mund të bëhen rregullime në programet kohore të përkohshme (përkatëse) për të reflektuar faktorët e përshkruar më sipër, duke siguruar kështu propozime të përballueshme dhe praktike.

Objektivat e planit të përgjithshëm për përafrimin e plotë jepen në Tabelën 1 më poshtë (duke filluar nga viti 0).

*Tabela 1: Objektivat e planit të përgjithshëm të përafrimit*

Plani i Përgjithshëm i Përafrimit	Fillimi (muaji/viti)	Përfundimi (muaji/viti)
<i>Transpozimi Ligjor</i>	<i>01/0000</i>	<i>06/0002</i>
<i>Zbatimi dhe Detyrimi</i>	<i>07/0002</i>	<i>12/0009</i>

### 4.3 Plani i transpozimit

Plani i transpozimit bazohet në rezultatet e analizës së boshllëkut ligjor që në vetvete formojnë bazën për identifikimin dhe marrjen e vendimeve mbi veprimet e ardhshme që kërkohen për plotësimin e transpozimit të Direktivës së Nitrateve.

Këto veprime marrin si pikë të tyre fillimi draftin LBU të përgatitur nga projekti ELPA dhe bazohen në amendamentin në këtë draft dhe përgatitjen e legjislacionit ndihmës sipas këtij drafti të ri LBU. Këto veprime përgatiten dhe diskutohen me Ministrinë dhe aktorë të tjerë.

Veprimet kryesore të planit të transpozimit përfshijnë:

<sup>5</sup> Një program kohor realist (absolut) për transpozimin ligjor dhe zbatimin (implementimin) e ngjashëm të këtyre direktivave/rregulloreve, duke marrë në konsideratë burimet dhe buxhetet e kufizuara në dispozicion, duhet të përcaktohet si pjesë e një Strategjie Kombëtare për Përafrimin Mjedisor (që nuk është pjesë e këtij studimi), ku kërkesat për burime të të gjithë sektorëve vendosen krahas krahasohen me burimet e përgjithshme të vlerësuara të disponueshme.

- Amendimin e LBU për të transpozuar kërkesat bazë të Direktivës së Nitrateve dhe dhënien e bazës së saktë ligjore për legjislacionin ndihmës për të plotësuar këtë transpozim;
- Rishikimin dhe nëse është e nevojshme, ripunimin e ndonjë legjislacioni përkatës “ bujqësor” për të siguruar që ai nuk është i papajtueshëm me Direktivën dhe me LBU e amenduar;
- Përgatitjen e një Rregulloreje mbi Ndotjen e Nitrateve nga Burimet Bujqësore sipas LBU të amenduar që do të transpozojë pjesët e ndara të Direktivës;
- Përgatitjen e një Kodi ose Kodeve të Praktikës së Mirë Bujqësore.

#### 4.4 Plani i Zbatimit dhe Detyrimit

Direktiva e Nitrateve ka qënë një prej pikave më të debatueshme të legjislacionit të BE-së që duhet të implementohen. Trembëdhjetë nga 15 shtete anëtare ‘të vjetra’ (BE-15) kanë qënë në një kohë të caktuar objekt i procedimeve ligjore në lidhje me transpozimin e paplotë ose mos zbatimin e duhur. Shtatë nga to ishin ende të diskutueshme në kohën e raportit të Komisionit të vitit 2007 mbi zbatimin e Direktivës (COM (2007) 120).

Rezultate kryesore të analizës së hollësishme kanë krijuar bazën për identifikimin dhe marrjen e vendimeve mbi zbatimin e ardhshëm të kërkuar dhe veprimet e zbatimit. Ato veprime do të mundësojnë zbatimin dhe detyrimin e plotë të kësaj Direktive dhe janë thelbi i Planit të Zbatimit.

Veprimet e nevojshme për të siguruar zbatimin dhe detyrimin e plotë të kësaj Direktive paraqiten në Tabelën 2 më poshtë, së bashku me një përshkrim të shkurtër të veprimeve të propozuara, institucionit përgjegjës dhe një periudhë të propozuar zbatimi.

Tabela 2: Veprimet e zbatimit dhe detyrimit

Veprimi	Institucioni Përgjegjës	Periudha e Zbatimit (muaji/viti)
<u>Të caktojë dhe instruktojë një Autoritet/autoritete Kompetent</u> /e (në nivel kombëtar dhe/ose baseni lumor) . Të ndërtojë kapacitetin e AK për të implementuar Direktivën e Nitrateve.	Qeveria, MMPAU, MBUMK, KKU, KBL-të	04/0000 – 06/0000
<u>Identifikimi i ujrave që mund të preken nga nitrati.</u> Zbulimi i ujrave të rrezikuara ose të ndotura do të bazohet në të paktën 1 vit monitorim të dhënash. Bazuar në këto rezultate, do të përcaktohen zonat e prekshme.	Autoriteti Kompetent, Ministrinë Përkatëse	07/0000 – 12/0001
<u>Planifikimi i zonave të prekshme nga nitratat (ZPN).</u> Zonat e prekshme do të caktohen me qëllim që të mbrojnë mjedisin ujor nga nivelet e larta të ngarkesës së nitrarit. Prodhimi bujqësor që kontribuon në ndotjen e ujit brenda një ujëndarëseje që ndikohet ose mund të ndikohet nga ndotja, do të caktohet si zonë e prekshme. Më tej, do të kufizohet prodhimi bujqësor në zonat e prekshme, midis të tjerash në lidhje me një Kod të Praktikës së Mirë Bujqësore (KPMB).	Autoriteti Kompetent, Ministrinë Përkatëse	01/0002 – 12/0002
<u>Trajnimi dhe informacioni i fermerëve mbi KPMB</u>	MBUMK	01/0004 –

Krijimi sipas nevojës i një programi që përfshin sigurimin e trajnimit dhe informimit për fermerët, duke nxitur zbatimin e KPMB.		06/0004
<u>Përpunimi i Programeve të Veprimit për zonat e prekshme me rregulla detyruese.</u> Programet e veprimit janë programe të masave ligjërisht detyruese të synuara për zvogëlimin ose parandalimin e mëtejshëm të ndotjes nga nitratat në zonat e prekshme dhe do të përfshijnë masa si ekuilibri i nitratit, magazinimi i plehut organik, shpërndarja e <170 kg plehu organik N/hektarë/në vit në tokë <sup>6</sup> . KPMB do të jetë e detyrueshme në zonat e prekshme ( përveç rasteve kur masat KPMB zëvendësohen me masa të tjera programesh veprimi).	Autoriteti Kompetent, Ministritë Përkatëse	01/0001 – 12/0003
<u>Të implementojë programet e veprimit dhe KPMB në zonat e prekshme dhe të implementojë vullnetarisht KPMB në fermat jashtë zonave të prekshme.</u> Ato ferma të specifikuar në programin e veprimit, dmth të profilin dhe madhësisë së caktuar, për të implementuar masa sipas programit kohor të përcaktuar në program.	Fermat në zonat e prekshme	06/2004 →
<u>Zbatimi i programit kombëtar për monitorimin e përqëndrimit të nitratit në ujrë dhe ëmbla dhe sistemi i raportimit.</u> Direktiva kërkon paraqitjen e raportit pranë Komisionit çdo 4 vjet pas njoftimit të tij. Ky raport duhet të përfshijë informacion në lidhje me kodet e praktikës së fermës së mirë, zonat e caktuara të prekshme nga nitratat, rezultatet e monitorimit të ujit dhe një përmbledhje të aspekteve përkatëse të programeve të veprimit për zonat e prekshme.	Autoriteti Kompetent, Ministritë Përkatëse	01/0002 – 12/0003
<u>Të sigurojë burime për zbatim</u> Inspektorët do të nevojiten që të sigurojnë fermerët në ZP që të pajtohen me kërkesat.		

Veprimet e identifikuar të zbatimit mund të përpilohen në katër grupet e mëposhtme të veprimeve:

1. Forcimi institucional dhe ndërtim kapacitetesh.
2. Punë përgatitore dhe formulim i programeve të veprimit.
3. Monitorim, trajtim të dhënash dhe raportim.
4. Zbatimi i programeve të veprimit dhe deyrimit.

### **Forcimi institucional dhe ndërtimi i kapaciteteve**

- *Të caktojë një Autoritet Kompetent:* Duhet të caktohet një Autoritet Kompetent (AK) dhe duhet të identifikohet dhe punësohet<sup>7</sup> stafi i kërkuar për zbatimin e Direktivës. Duhet të prokurohet hardueri dhe softueri i nevojshëm. Duhet të sigurohet trajnim në detyrat e kërkuara për zbatimin e Direktivës. Do të hartohen masat institucionale (delegimi

<sup>6</sup> Direktiva lejon derogimet nga ky kufizim por vetëm kur kjo mund të justifikohet dhe në rast se nuk do të çënojë objektivat e Direktivës.

<sup>7</sup> Në praktikë, ka gjasa të ketë të paktën dy autoritete kompetente, MMPAU, për shembull që është përgjegjëse për zbatimin e përgjithshëm dhe MBUMK përgjegjëse për shtrirjen në ferma, Kodi i Praktikës së Mirë Bujqësore dhe zbatimi.



i përgjegjësive, përkufizimi i procedurave të punës, marrëdhënia midis aktorëve etj).

- *Kapaciteti laboratorik:* AK duhet të sigurojë që ka kapacitet të mjaftueshëm për matjen e nitratit në ujrat sipërfaqësore dhe ujrat tokësore. Mjediset egzistuese laboratorike janë teknikisht të mjaftueshme për të përmbushur nevojat aktuale. Megjithatë, kërkohet investim në rinovimin laboratorik, përmirësimin, sigurimin e pajisjeve dhe metodave të përshtatshme (jo domozdoshmërisht të reja), stafin profesional të kualifikuar dhe trajnuar dhe akreditim në përputhje me standardin ISO 17025.
- *Asistenca teknike për të ndihmuar AK të planifikojë dhe ndërmarrë aktivitete fillestare dhe roudin e parë të programeve të veprimit:* Kjo do të përfshinte përcaktimin e kufijve të saktë, mekanizmat e bashkërendimit dhe strukturat e komunikimit midis autoriteteve të ndryshme, veçanërisht MMPAU, MBUMK dhe KBL-të, sigurimin e trajnimit, përgatitjen e përshtatshme të punës, planet e punës dhe manualët e procedurave dhe mbështetjen e agjencive përkatëse që të realizojnë raundine tyre të parë të planifikimit dhe detyrave, duke përfshirë aktivitetet e mëposhtme të specifikuara më poshtë:
  - Përgatitja e një programi për përhapjen dhe promovimin e kodit të praktikës së mirë bujqësore dhe krijimi i ndërgjegjësimit tek fermerët përkatës;
  - Identifikimi dhe caktimi i kufijve të zonave të prekshme;
  - Hartimi i programeve të veprimit.

### **Puna përgatitore dhe formulimi i programeve të veprimit**

- *Identifikimi i ujrave që janë prekur ose nëse nuk do të merreshin masa, mund të prekeshin nga ndotja prej nitratit ose eutrofikimi.* AK duhet të përgatisë kriteret për përkufizimin dhe përcaktimin e shkallës së eutrofikimit në ujrat e prekura<sup>8</sup> dhe duhet të përgatisë kriteret për përkufizimin dhe përcaktimin e shkallës së ujrave të prekura nga ndotja e nitratit, në përputhje me Aneksin 1 të Direktivës. Përfshirja e aktorëve kryesorë për të marrë pjesë në këtë proces, siguri i konsulencës më të fundit shkencore, arritja e pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së dhe respektimi i detyrimeve sipas Konventave Ndërkombëtare ku Shqipëria është nënshkruese janë kritike për këtë fazë zbatimi. Duhet të identifikohen ato ujra që tejkalojnë ose janë në rrezik të tejkalojnë 50 mg/l azot. Midis të tjerash, këto përfshijnë:
  - Ujrat sipërfaqësore, veçanërisht ato për abstragimin e ujit të pijshëm,
  - Ujrat tokësore që përmbajnë më shumë se 50 mg/l nitrate,

---

<sup>8</sup> Deri tani nuk ka patur kritere të përbashkëta për shtetet anëtare që të vlerësojnë gjendjen trofike të ujrave sipërfaqësore dhe kjo ka penguar diskutimin dhe krahasueshmërinë. Kur rezultatet e ushtrimit të ndërkalibrimit sipas direktivës kuadër të ujit bëhen të njohura, këto do të shpresohen të përfshijnë rekomandime në lidhje me harmonizimin e kriterëve për të përkufizuar eutrofikimin (Raport i Komisionit Evropian për Këshillin dhe Parlamentin Evropian mbi zbatimin e Direktivës së Nitrateve për periudhën 2000-2003). COM(2007) 120 përfundimtar, mars 2007.



- Liqene me ujra të ëmbla, masa të tjera me ujë të ëmbël, grykëderdhje të gjera, ujra bregdetare dhe ujra detare që janë ose mund të bëhen eutrofike.

Zonat ujëmbledhëse që drenazhojnë ujë të ndotur nga nitratet në masat e ujrave sipërfaqësore duhet të përcaktohen mbi bazën e një përqasjeje të basenit lumor.

- *Përcaktimi i zonave të prekshme:* Zonat e prekshme përkufizohen në Nenin 3(2) si të gjitha zonat e njohura të tokës që drenazhohen në ujrat [e ndotura ose që mund të ndoten] të identifikuar më lart dhe që kontribuojnë në ndotje. Me qëllim që të bëhet identifikimi i duhur i këtyre zonave, autoriteti kompetent duhet të ketë (i) të dhëna monitoruese përfaqësuese për të gjithë sipërfaqen që mund të ndotet dhe ujrat tokësore dhe (ii) rishikim të kryer sipas DKU-së mbi ndikimin e aktivitetit njerëzor në gjëndjen e ujrave sipërfaqësore dhe ujrave tokësore. AK ka opsionin, nëse dëshiron, të trajtojë të gjithë territorin kombëtar sikur të ishte një zonë e prekshme, si alternativë për përcaktimin e zonave specifike. Kjo ka edhe avantazhe, edhe disavantazhe (shihni tabelën më poshtë)

*Tabela 3: Avantazhet dhe disavantazhet e trajtimit të të gjithë territorit kombëtar si një ZP*

<p><i>Avantazhet</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shmang një pjesë të punës për caktimin e zonave të prekshme</li> <li>• Shkurton kostot e monitorimit të vëzhgimit (por jo të monitorimit operacional)</li> <li>• Më i lehtë për të 'shitur' për Komisionin Evropian</li> <li>• Trajtim i veçantë, i qëndrueshëm i të gjitha fermave në vend</li> </ul>
<p><i>Disavantazhet:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nuk është i leverdisshëm ekonomikisht nëse ka një numër të madh fermash që nuk kontribuojnë në ndotjen nga nitratet</li> </ul>

Përgjithësisht, do të kishte më shumë disavantazhe sesa avantazhe, dmth nuk do të ishte e favorshme të trajtohej i gjithë territori kombëtar sikur të ishte një ZP, nëse raporti i territorit i cili do të duhet të përkufizohej një ZP, është i lartë.

*Të planifikojë programe veprimi për zonën/zonat e prekshme:* AK duhet të shqyrtojë nëse duhet të zbatojë një program veprimi për të gjitha zonat e prekshme ose të hartojë programe të ndryshme për zona të ndryshme të prekshme. Programet e veprimit duhet:

- Të marrin parasysh të dhënat e disponueshme teknike dhe shkencore mbi kontributet e azotit që e kanë origjinën nga burimet bujqësore dhe burime të tjera dhe mbi kushtet mjedisore;
- Të përmbajnë si të detyrueshme masat e parashtruara në Aneksin III (periudha kur aplikimi i disa plehëruesve ndalohej, kufijtë mbi sasi të plehëruesve të aplikuar, një kufi mbi aplikimin e plehut të bagëtive për hektar për një sasi që përmban jo më shumë se 170 kg N ose 210 kg N gjatë ciklit të parë katër vjeçar të programit të veprimit, kushtet në lidhje me

kapacitetin e disponueshëm të magazinimit mbi fermat ose plehun e bagëtive)

- Të marrin masat e përcaktuara në kodin e praktikës së mirë bujqësore të detyrueshme ( përveç rasteve kur zëvendësohen nga masat e Aneksit III);
- Të specifikojnë masa të mëtejshme të leverdisshme ekonomisht, të cilat nevojiten për arritjen e objektivave të Direktivës.

Programet përfundimtare të veprimit hartohen pas miratimit të Planeve të Menaxhimit të Basenit Lumor që kërkohen nga Direktiva Kuadër e Ujit. Programet e veprimit duhet të përmbajnë:

- Kufij mbi aplikimin e plehëruesve.
- Një kapacitet minimal magazinimi të enëve të mbajtes për plehun e bagëtive,
- Masa për të parandaluar ndotjen e ujit nga derdhjet dhe rrjedhjet në ujrat tokësore dhe sipërfaqësore të lëngjeve që përmbajnë pleh bagëtish.

Ato mund të përfshijnë një kërkesë që fermat të mbajnë të dhënat e nevojshme ose të hartojnë plane menaxhimi, në varësi të përmbajtjes së saktë të programeve të veprimit.

- *Rritja e ndërgjegjësimit, shpërndarja e informacionit, konsulenca dhe pjesëmarrja:* AK duhet të vlerësojë fushën e veprimit të opsioneve për rritjen e ndërgjegjësimit dhe trajnimin e fermerëve dhe përfaqësuesve të tyre rreth implikimeve të Direktivës dhe të vendosin në lidhje me hapat e nevojshme. Kjo duhet të arrihet në konsultim dhe me pjesëmarrjen e Ministrive përkatëse dhe organeve të tjera në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal, si dhe organizatat e fermerëve. Konsulenca duhet të fillojë në një fazë të hershme. Autoriteti Kompetent duhet të përgatisë gjithashtu një plan për shpërndarjen e informacionit mbi kodet e praktikës së mirë bujqësore dhe mbi programet e veprimit që përdorin workshope, grupe pune për detyrat, broshura, takime informuese, trajnim dhe projekte pilot. Përgatitja e këtyre aktiviteteve duhet të bëhet në bashkëpunim me palë të tjera të interesuara dhe të përfshira si shoqatat e fermerëve, autoritetet rajonale dhe lokale dhe Ministri të tjera.

### **Monitorimi, trajtimi i të dhënave dhe raportimi**

- *Hartimi i programeve të monitorimit për:* a) të vlerësuar nitratat në ujrat sipërfaqësore dhe tokësore, b) të rishikuar gjendjen eutrofike të ujrave të ëmbla sipërfaqësore, ujrave të grykëderdhjeve të gjera dhe ujrave bregdetare, dhe c) për të vlerësuar efektivitetin e programeve të veprimit: AK do të përcaktojë vendndodhjet e marrjes së mostrave për monitorimin e cilësisë së ujit të ujrave sipërfaqësore dhe tokësore, në përputhje me kërkesat e Direktivës. Vendndodhjet e marrjes së mostrave mund të përfshinin vendndodhjet e vendosura të monitorimit të cilësisë së ujit sipas ndonjë sistemi monitorues kombëtar ose stacioneve të tjera përfaqësuese të kushteve të ujrave sipërfaqësore dhe/ose ujrave tokësore dhe/se shtresave ujëmbajtëse të ujrave tokësore.

Programi i monitorimit duhet të përfshijë marrjen e mostrave dhe testimin e vlerësuar për të paktën një vit fillimisht për të marrë të dhëna mbi nivelet e nitrateve dhe shkallën e eutrofikimit të ujrave sipërfaqësore dhe tokësore dhe përsëritet të paktën çdo katër vjet. Programi i marrjes së mostrave duhet të zbatohet për ujrat e ëmbla të brendshme ku toka bujqësore mund të drenazohet në to ose drejtpërdrejt ose nëpërmjet lumenjve. Sistemi i monitorimit dhe marrjes së mostrave duhet të japë informacion mbi shkallën e ndotjes nga nitratat si dhe mbi progresin e arritur nga zbatimi i programeve të veprimit.

Të dhënat e grumbulluara nga programet monitoruese duhet të rishikohen nga Autoriteti Kompetent ose në shkallë kombëtare ose në shkallë lokale dhe rishikimi grumbullohet dhe ruhet në një sistem të përshtatshëm si Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Laboratorik ose ndonjë sistem i ngjashëm. Gjithashtu, Autoriteti Kompetent do të krijojë baza të dhënash efektive dhe sistem raportimi për të mundësuar regjistrimin dhe raportimin e informacionit të grumbulluar si rezultat i zbatimit të kërkesave të Direktivës. Të dhënat përkatëse egzistuese (zonat, karakteristikat e tokës, përdorimi i tokës, praktikat bujqësore, ujrat sipërfaqësore dhe tokësore, burimet bujqësore dhe jobujqësore të nitrateve etj) duhet të rishikohen dhe futen në bazat e të dhënave. Do të jetë e nevojshme të sigurohet kapaciteti raportues brenda Autoritetit Kompetent mbi:

- Përcaktimin e zonave të prekshme nga nitratat, duke përfshirë rezultatet e monitorimit,
- Programet e veprimit, duke përfshirë kërkesat e ruajtjes dhe kufizimet në aplikimin e plehut organik,
- Kodet e praktikës së mirë bujqësore,
- Rishikimin e përcaktimeve të zonave të prekshme; dhe
- Afatet kohore për përmirësimet e pritshme.

### **Zbatimi i programeve të veprimit dhe detyrimit**

- *Implementimi i programeve të veprimit:* Pasi të formulohen programet e veprimit, ato duhet të implementohen gradualisht. Kjo do të jetë detyra e fermerëve ose pronarëve të vetë ndërmarrjeve blegtorale. Duke gjykuar nga përvoja e mëparshme e Komisionit Evropian, mund ta konsiderojë të pranueshme që zbatimi nuk fillon deri në datën e aderimit në BE.
- *Zbatimi:* Autoriteti kompetent për zbatimin e Direktivës së Nitrateve duhet të hartojë një plan zbatimi. Kjo nënkupton përcaktimin e fermave në zonat e prekshme që kanë detyrime sipas programeve të veprimit, duke vendosur një orar inspektimi dhe siguruar që inspektorati të ketë burimet e nevojshme njerëzore, transport, përdorim instrumentash dhe buxhet për kryerjen e detyrës.

## 5 Kostot dhe Fitimet

Ky kapitull kërkon të vlerësojë kostot e përafrimit të Direktivës së Nitrates në Shqipëri dhe të rendisë përfitimet përkatëse. Asnjë nga këto detyra nuk është e drejtpërdrejtë për momentin. Në lidhje me kostot, ende nuk është e mundur të jesh specifik sepse nuk ka një panoramë të qartë se në ç’nivel ujrave sipërfaqësore dhe tokësore shqiptare “preken nga ndotja prej nitrates ose mund të prekeshin nëse nuk do të merreshin...masa” në kuptimin e Nenit 3 të Direktivës. Për sa i përket fitimeve, këto janë identifikuar por nuk është bërë asnjë përpjekje për t’i matur nga pikëpamja sasiore në këtë fazë në çdo rast. Jo vetëm që kjo do të ishte një ndërmarrje shumë e vështirë-pjesërisht për arsyen e dhënë në lidhje me kostot por edhe për shkak të paprekshmërisë së shumë fitimeve dhe faktit që të dhënat e nevojshme që kërkohen të përcaktojnë sasinë e fitimeve edhe më të prekshme, nuk janë të disponueshme. Në çdo rast, një përcaktim i sasisë së përgjithshme të fitimeve, megjithëse do të ishte interesant, nuk përfshihet në këtë Plan. Zbatimi i Direktivës është një marrëveshje meqë Shqipëria propozon të bëhet anëtare e Bashkimit Evropian dhe çështja është sesi mund të arrihet kjo me efektivitet dhe leverdi ekonomike. Rrethanat e vetme në të cilat një ushtrim i kufizuar në vlerësimin e fitimeve mund të ishte i nevojshëm, do të ishin në një rast specifik ku kostot e arritjes së objektivave të DKU për një masë ujore specifike do të ishin disproporcionalisht të larta.

Seksioni 5.1 vlerëson burimet e kërkuara për përafrimin, seksioni 5.2 shqyrton burimet nga të cilat mund të financoheshin këto kosto dhe seksioni 5.3 identifikon fitimet që rrjedhin nga Direktiva.

### 5.1 Burimet dhe Kostot

#### 5.1.1 Metoda e vlerësimit të kostos dhe burimet e të dhënave mbi koston

Kostot e (i) transpozimit të plotë të Direktivës së Nitrates në legjislacionin shqiptar dhe (ii) zbatimi i saj janë vlerësuar veçmas.

Në rastin e transpozimit ligjor, pika e fillimit ishte lista e veprimeve të transpozimit e renditur në seksionin 4.3. Supozohet që këto veprime do të kryhen nga stafi përkatës juridik dhe i politikave të MMPAU dhe MBUMK me mbështetjen e asistencës teknike. Kjo asistencë teknike vlerësohet mbi bazën e nivelit të mbështetjes së nevojitur për kryerjen e punës së

nevojshme dhe supozimet standarde rreth kostove të njësisë së sigurimit të këtyre të dhënave.

Pika e fillimit për zbatimin e llogaritjes së kostove ishte lista e ndërhyrjeve në përmbajtje të Tabelës 2. Kjo listë u zbërtye më tej në veprime dhe nënveprime siç përcaktohet në Aneksin III.

Kërkesat për burime të secilit veprim u vlerësuan nga ekspertët e projektit. Këto burime përbënin:

- Burimet njerëzore (burimet përgjithësisht supozohen të jenë burime të reja që do të kërkohen vazhdimisht),
- Kërkesat për trajnim,
- Masat teknike dhe planifikuese duke përfshirë blerjen e pajisjeve të nevojshme,
- Nxjerrjen e dokumentave të nevojshme,
- Projekte/ekspertë të asistencës teknike (burimi i alokuar për projektet e asistencës teknike u bazua në vlerësime duke iu referuar përvojës së të dhënave të projekteve të asistencës së nevojshme teknike ( AT ) në lidhje me konsulentët ndërkombëtarë dhe kombëtarë dhe burime të tjera),
- Shpenzimet që nevojiten për çdo konsulencë të nevojshme të fermerëve dhe aktorëve të tjerë dhe të fushatave të nevojshme për të informuar këto grupe dhe për të rritur ndërgjegjësimin e tyre, dhe
- Zbatimin

U krye një vlerësim i kostove të këtyre burimeve. Rezultatet e kësaj llogaritjeje kostosh jepen më poshtë. Metodrat e ndjekura në llogaritjen e kostove dhe disa supozime të përgjithshme të bëra përshkruhen në seksionet e mëposhtme.

Një problem që lind është se natyra ose shkalla e disa veprimeve varet ( siç nuk bërë ende e ditur) nga rezultatet e veprimeve të mëparshme. Një shembull është se madhësia e zonave të prekshme dhe për rrjedhojë kostove që do të shkaktohen nga feramat nuk do të bëhen të ditura derisa të jenë studiuar të dhënat egzistuese mbi cilësinë e ujit, të jenë ndërmarrë aktivitete të mëtejshme monitoruese dhe të jetë marrë një vendim për zonat në rrezik nga ndotja prej nitrateve (shih më poshtë). Kjo pasiguri trajtohet ose duke tërhequr vëmendjen ndaj nivelit të pasigurisë së përfshirë dhe përcaktimit të veprimeve të ardhshme që do të zvogëlojë këtë pasiguri ose nga përdorimi i një metode të stilit-skenar ku shqyrtohen alternativa të ndryshme.

Burimet e nevojshme vlerësohen nga ekspertët e projektit. Metodrat e vlerësimit të kostos dhe/ose burime të të dhënave përdoren siç paraqiten shkurtimisht në Aneksin V

Të gjitha kostot llogariten me çmimet kostante të vitit 2008.

### 5.1.2 Çështjet kryesore në llogaritjen e kostos së Direktivës së Nitratesve për Shqipërinë

Egzistojnë katër pyetje kryesore të cilave duhet t'u jepet përgjigje mbi mënyrën drejt llogaritjes së kostos së Direktivës së Nitratesve për Shqipërinë.

Ato janë:

- Cila është shkalla e ndotjes nga nitratat në Shqipëri?
- Në çfarë niveli është bujqësia përgjegjëse për ndotjen nga nitratat?
- Cila përqindje e territorit shqiptar duhet të caktohet si zonë e prekshme?
- Si do të trajtohen fermat me familje të vogla?

Këto pyetje shqyrtohen me rradhë si më poshtë

*Pyetja kryesore 1: Cila është shkalla e ndotjes nga nitratat në Shqipëri?*

ND kërkon që shtetet anëtare të marrin në konsideratë ujrat “ e prekura nga ndotja” që mund të ishin ndotur në mungesë të masave përkatëse. Të prekura nga ndotja nënkupton në këtë kontekst:

- Në rastin e ujrave të ëmbla sipërfaqësore: më shumë se përqëndrimi i nitratesve i përcaktuar nga Direktiva 75/440/KEE; vlera kufi për nitratin sipas këtij të fundit është 50 mg/l;
- Në rastin e ujrave sipërfaqësore në përgjithësi (dmth, duke përfshirë grykëderdhjet e gjera, ujrat bregdetare dhe ujrat detare) nëse janë eutrofike ( që nuk përcaktohen në Direktivë);
- Në rastin e ujrave tokësore: 50 mg/l.

Provat sesi cilësia e ujit në Shqipëri krahasohet me këto vlera shqyrtohet më poshtë, veçmas për ujrat sipërfaqësore dhe ujrat tokësore. Duhet të vërehet se uji tokësor luan një rol mjaft të rëndësishëm në ujin e pijshëm në Shqipëri, me 80 % të furnizimit me ujë të pijshëm që vjen nga shtresat ujëmbajtëse kryesore në vend.

Provat kryesore në dispozicion janë natyrisht të dhëna monitoruese të mbledhura nga stacionet monitoruese. Të dhënat monitoruese mund të jenë të mira vetëm nëse rrjeti monitorues ka një mbulim të mirë dhe është përfaqësues i masave ujore në Shqipëri dhe nëse programi ka shpeshtësi dhe saktësi të mjaftueshme. Figure 1 nga ana tjetër e faqes tregon vendndodhjet e stacioneve monitoruese të ujit tokësor dhe sipërfaqësor në Shqipëri. Ai tregon gjithashtu vendndodhjen e tokës së përdorur për bujqësi dhe kullotat. Mund të shihet që rrjeti monitorues për ujin tokësor është mjaft i kufizuar. Për më tepër (dhe kjo nuk mund të shihet në hartë), stacionet e ujrave tokësore kanë tendencën të përqëndrohen në shtresa ujëmbajtëse më të thella që janë burimet kryesore të ujit të pijshëm, pa i kushtuar shumë rëndësi ujrave tokësore të cekëta në zonat bujqësore që janë më të prekshme nga ndotja prej nitratesve.



Figura 1: Vendndodhja e tokës bujqësore në Shqipëri dhe e stacioneve monitoruese të cilësisë së ujit.



### *Ujrat sipërfaqësore*

Organizata përgjegjëse për monitorimin e ujrave sipërfaqësore është Instituti për Energjinë, Ujin dhe Mjedisin në Universitetin Politeknik të Tiranës. Përqëndrimet e nitratis llogariten midis tre dhe gjashtë herëve në vit në 30 stacione matëse në lumenjtë e shpërndarë në vend. Shifrat për vitin 2007 jepen si më poshtë:

Vlera më e lartë prej NO<sub>3</sub>: 6.9 mg/l, në Shkumbin, në Rrogozhinë

Vlera mesatare (30 stacione): 1.2 mg/l

Vlera më e ulët: 0.04 mg/l (në disa vendndodhje)

Vlerat për vitin 2006 duken disi më të larta me një vlerë maksimale të regjistruar prej 16.0 mg/l mbi lumin Ishëm, dhe vlera rreth 10 mg/l që maten në disa raste.

Miho etj (2005)<sup>9</sup> raportuan nivele nitrati më tepër se “vlera udhëzuese” e BE-së për ujin e pijshëm prej 25 mg/l NO<sub>3</sub> në seksionet në drejtim të rrjedhjes së Shkumbinit.

Për sa i përket liqeneve, cilësia e ujit monitorohet në tre liqene të mëdha shqiptare të Shkodrës (3 vendndodhje të ndara), Ohri dhe Prespa. Mostrat e ujit merren tre herë në vit në thellësi të ndryshme. Përqëndrimet e llogaritura janë të gjitha të ulta në raport me standardin- asnjë vlerë më e madhe se 0.2 mg/l NO<sub>3</sub> krahasuar me standardin prej 50 mg/l.

Siç është përmendur më lart, kriteri në Direktivë për “i prekur nga ndotja” përfshin jo vetëm kriterin kimik (përqëndrimi i nitratis) por edhe gjendjen trofike të ujrave. Çdo masë ujore sipërfaqësore që cilësohet të jetë eutrofike konsiderohet rrjedhimisht si e ndotur për qëllim të ND, por nuk ka monitorim sistematik të eutrofikimit në ujrat shqiptare.

### *Ujrat tokësore*

Përqëndrimet e nitratis (mes parametrave të tjera të cilësisë) në ujrat tokësore monitorohen nga Vëzhgimi Gjeologjik Shqiptar. Mostrat merren nga pusët në vendndodhje të ndryshme, dy herë në vit, në 7 shtresa ujëmbajtëse<sup>10</sup>. Rezultatet për vitin 2007 përmbledhen në tabelën e mëposhtme

*Tabela 4: Përqëndrimet e monitoruara të nitratis në ujrat tokësore (mg/l NO<sub>3</sub>), 2007*

Shtresat ujëmbajtëse	Nr i pikave	NO <sub>3</sub> maksimale	NO <sub>3</sub> minimale
Tirana	5	22	3.2
Fushe Kuqe 1	5	2	0.8
Fushe Kuqe 2	4	10	0.8
Korce	4	14	1.2
Elbasan	3	4	1.2

<sup>9</sup> Miho A., Cullaj A., Hasko A., Lazo P., Kupe L., Schanz F., Brandl H., Bachofen R., Baraj B.: Gjendja mjedisore e disa lumenjve të Ultësirës Adriatike Shqiptare. Programi SCOPEs (Fondacioni Zvicerian i Shkencave Natyrore - SNSF), Tirana (në shqip, me një përmbledhje në gjuhën angleze), 2005.

<sup>10</sup> Mostrat janë marrë në një shtresë ujëmbajtëse të tetë (Lezhe), por nuk ka asnjë analizë NO<sub>3</sub>.



Lushnje	1	0.4	0.4
Shkoder	4	10.8	0.8

Burimi: Vëzhgimi Gjeologjik Shqiptar

Rezultatet e monitorimit të vitit 2006 janë të krahasueshme megjithëse në përgjithësi paksa më të larta. Përqëndrimi maksimal në Korçë ishte 22 mg/l, dhe në Shkoder 17.6 mg/l.

Përqëndrimet e monitoruara të nitratit janë shumë më poshtë vlerës kufi prej 50 mg/l për ujrat tokësore por më të larta sesa për ujrat sipërfaqësore, megjithatë, veçanërisht shtresa ujëmbajtëse e Tiranës por të dhënat monitoruese të ujrave tokësore përqëndrohen në një numër të vogël pozicionesh monitoruese në shtresa ujëmbajtëse më të mëdha, në përgjithësi më të thella nga të cilat ka abstragime të ujit në shkallë të gjerë. Është një problem që pusët më të cekëta të përdorura nga popullsia rurale në fushat bregdetare që janë gjerësisht të kultivuara, mund të kenë nivele më të larta nitrati. Në 'Rishikimin e tij të Performancës Mjedisore' në vitin 2002, Komisioni Ekonomik për Evropën (KEE) deklaroi se nivelet e 'larta' të nitrates janë konstatuar në ujrat tokësore në basenet e Semanit dhe Vjosës, megjithëse nuk ishin ofruar të dhëna sasiore. Vlerat deri në 30.4 mg/l janë matur në rezervuarin e Bovillës dhe pusët e shkarkimit të ujrave në fushat bregdetare<sup>11</sup>. Sulçe etj (2006)<sup>12</sup> përmendin se në 22 analiza të ujit për ujin e pijshëm nga pusët në zonën bujqësore të Durrësit në basenet lumore të Ishmit dhe Erzenit, 18 puse kishin nivele NO<sub>3</sub> më të larta se 66 mg/l, dmth më të larta se standardi i BE-së.

**Përfundime të përkohshme (që i nënshtrohen monitorimit të synuar të mëtejshëm):**

**Gjendja e nitratit të masave ujore në Shqipëri**

1. Nivelet e nitratit të ujrave sipërfaqësore duken të jenë më poshtë ose shumë më poshtë se 50 mg/l.
2. Shtresat ujëmbajtëse kryesore të thella janë ende më të ulta se 50 mg/l, megjithëse disa prej tyre mund të jenë në kategorinë e "ujrave që mund të prekeshin nga ndotja nëse nuk merren masa".
3. Janë regjistruar tejkalime të standardit të BE-së në pusët e cekëta në zonat bujqësore në fushën bregdetare. Programi i monitorimit të vëzhgimit duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë mjedisëve të këtij lloji ku ndotja mund të jetë lokale.

*Pyetja kryesore 2: Në çfarë shkalle është bujqësia përgjegjëse për ndotjen nga nitratat në Shqipëri?*

Për shkak të metodës me anë të së cilës ishte rishpërndarë toka bujqësore pas rënies së komunizmit, zotërimi i tokës bujqësore në Shqipëri është shumë i copëzuar. Shumë ferma janë zotërimi familjesh të vogla me një

<sup>11</sup> Tania Floqi (Universiteti Politeknik i Tiranës): Prezantim "Cilësia e ujit dhe shëndeti – rasti shqiptar" paraqitur në Vrnjacka Banja, tetor 2007

<sup>12</sup> Sulçe, S., E. Veizaj: Vlerësim i ndotjes së mundshme nga aktivitetet bujqësore në rajonin e Durrësit ( Shqipëri)

madhësi mesatare prej jo më shumë se 1 hektar. Disa statistika kryesore të sektorit bujqësor kombëtar në Shqipëri tregohen në Kutinë 1 më poshtë.

#### Kutia 1: Statistika të rëndësishme të sektorit bujqësor në Shqipëri

Toka bujqësore e përgjithshme: 697,000 ha  
nga të cilat në pronësi private: 563,000 ha  
në pronësi shtetërore: 134,000 ha

Numri i fermave: 370,000

##### *Nga fermat shtëpiake:*

Madhësia mesatare e fermës: 1.2 ha  
24% janë në kufirin 0.1 – 0.5 ha,  
27% janë në kufirin 0.6 – 1.0 ha,  
37.5% janë në kufirin 1.1 – 2.0 ha,  
11.5% janë > 2 ha,  
Shumë prodhojnë vetëm për konsumimin e tyre.  
Vetëm rreth 40-45 % e fermerëve përdorin ushqim të blerë për bagëtitë.

##### *Për sektorin bujqësor në tërësi*

Shpërndarja e madhësisë:

82% e zonës bujqësore të zënë nga fermat < 3 ha  
15% e zonës bujqësore të zënë nga fermat 3 - 30 ha  
3% e zonës bujqësore të zënë nga fermat > 30 ha

##### *Fermat blegtorale*

Numri i fermave blegtorale = 14,788

92% kanë < 10 bagëti secila  
7.97% kanë 10 – 100 bagëti secila  
0.03% kanë > 100 bagëti secila

##### *Terreni*

- Vetëm 25% e zonës së tokës përbëhet nga ultësira, pjesa tjetër është kodrinore (47%) ose tokë alpine (28%).
- Vetëm 43% e tokës së fermës është në zonën e ulët
- Rreth 56% e tokës bujqësore ka një pjerrësi > 5%.

Burimet: MBUMK (2008)<sup>13</sup>


Projekti ADRIAFOOD (2007)<sup>14</sup>

Shifra më poshtë krahason intensitetin e tokës të përdorimit të plehërizuesve artificialë në Shqipëri me disa vende të tjera evropiane.

<sup>13</sup> MBUMK: bujqësia shqiptare në shifra, 2007, Tirana, shtator 2008

<sup>14</sup> Projekti ADRIAFOOD Promovimi i një hapësire ndër-adriatike për prodhimin e perimeve dhe bagëtive cilësore. Gjendja aktuale e vendit- frutat/perimet dhe zooteknika

Figura 2: Konsumimi i plehërizuesve artificialë shqiptarë në krahasim me disa vende të tjera evropiane



Burimi: Banka Botërore: Baza e të dhënave për Treguesit e Zhvillimit Botëror

Në kutinë e mëposhtme bëhet një llogaritje e përafërt e mesatares bruto të pritshme të aplikimit të azotit në tokë nga plehu i kafshëve dhe plehërizuesit.

Kutia 2: Aplikimi i llogaritur vjetor bruto i azotit në tokën bujqësore në Shqipëri

Plehërizuesi artificial i përdorur në Shqipëri			
Tipi	Plehërizues(tonë)	Përqindja N (%)	N (tonë)
Urea	35,794	0.45	16,107
Nitrat amoni	44,401	0.35	15,540
Diamon Super	48,282	0.1	4,828
<b>Totali</b>			<b>36,475</b>
Plehu i kafshëve që duhet të agjësohen			
Tipi i bagëtive	numri	T N/a kafshë/vit	tonë N
Bagëti të mëdha	699,000	0.04	27,960
Derra	147,000	0.03	4,410
Dele dhe dhi	1,853,000	0.015	27,795
Shpendë	4,712,000	0.0012	5,654
<b>Totali</b>			<b>65,819</b>
Azoti total që duhet të aplikohet për tokën bujqësore= 102,000 tonë (afërsisht)			
Zona e tokës së përgjithshme bujqësore = 697,000 hektarë			
Norma mesatare e aplikimit = 102/697 T/hektarë = 146 kg/hektarë			

Burimi: MBUMK, shifrat për vitin 2004

Norma mesatare e aplikimit që zbatohet për normat aktuale të bagëtive dhe plehërimit, rreth 146 kg/hektarë mund të krahasohet me standardin e shpërndarjes së nitratit të BE-së- një maksimum prej 170 kg/hektarë –

përcaktuar në Direktivën e Nitraveve. Kjo nënkupton që për shkak të një sistemi efektiv për lëndët ushqyese të shpërndarjes së tokës (standardi aplikohet për çdo fermë) ky standard nuk duket të jetë shumë kërkuar.

Njëkohësisht, ka të ngjarë që sektori bujqësor në përgjithësi dhe sektori blegtoral në veçanti, janë minimalisht përgjegjës për ndonjë tejkalim të standardeve të nitraveve kur këto ndodhin veçanërisht në fushat bujqësore të ulta që shtrihen prapa brigjeve të Adriatikut.

*Pyetja kryesore 3: Cila përqindje e territorit shqiptar duhet të përcaktohet si zonë e prekshme?*

Mund të shihet që për momentin është shumë e vështirë të matet shkalla e ndotjes nga nitratat në zonat bujqësore të Shqipërisë. Përqëndrimet më të larta të nitraveve mund të jenë në ujë në pusët e cekëta në zona ku ka më shumë ferma, për shembull në fushat bregdetare të pjesës perëndimore të vendit. Në këto raste, burimet e nitratit mund të jenë lokale.

Pjesa e territorit kombëtar e caktuar si zonë e prekshme ka qënë një çështje e debatueshme në BE. Përqindja e caktuar nga shtete të ndryshme anëtare ka ndryshuar në nivel të konsiderueshëm ( shih tabelën më poshtë) dhe ka disa raste kur BE-ja e gjykon ose e ka gjykuar raportin mjaft të ulët.

*Tabela 5: Zonat e prekshme në EU-15 si pjesë të territorit të përgjithshëm*

Vendi	Përqindja e territorit të përcaktuar ZP (%)	Që i nënshtrohen procedurës ligjore nga BE-ja
Austria	100	
Belgjika	24	
Danimarka	100	
Finlanda	100	
Franca	44	
Gjermania	100	
Greqia	11	
Irlanda	100	
Italia	8	
Luksemburgu	100	
Hollanda	100	
Portugalia	1.2	
Spanja	13	
Suedia	15	
Mbretëria e Bashkuar	38	
<b>TOTALI BE 15</b>	<b>45</b>	

Burimi: Raport Përfundimtar i Komisionit Evropian COM(2007)120 mbi zbatimin e Direktivës së Nitraveve

Shënime për tabelën:

- Një e dhënë prej 100% në kolonën e dytë nuk nënkupton domosdoshmërisht që i gjithë territori është i prekshëm nga nitratat sipas Nenit 3(2) të Direktivës së Nitraveve por thjesht që vendi ka zgjedhur, në përputhje me nenin 3(5) të ND që të mos identifikojë zona specifike të prekshme nga nitratat por të krijojë dhe zbatojë një program veprimi në të gjithë territorin e saj.
- Mbushjet me ngjyrë jeshile dhe të kuqe në kolonën 3 nënkuptojnë përkatësisht që ka ose jo një procedurë shkeljeje ligjore në proces kundër shtetit anëtar përkatës.

Përqindja e territorit të përcaktuar varion nga 1.2% (Portugalia) në (në të vërtetë) 100% për 7 nga BE-15 që kanë zgjedhur të trajtojnë të gjithë territorin e tyre sikur të ishte i prekshëm. Duhet të vërehet se anëtarët jugorë përgjithësisht përcaktuan një përqindje shumë më të ulët të territorit të tyre si të prekshme nga nitratat sesa më shumë shtete anëtare veriore.

Tre nga dhjetë Shtete Anëtare të kohortës së aderimit të vitit 2004 (Malta, Sllovenia dhe Lituania) ndoqën një “përqasje të të gjithë territorit” dhe rrjedhimisht vendosën të mos përcaktonin zona specifike të prekshme nga nitratat por të implementonin një program veprimi për të gjithë territorin. Shtatë të tjerat përcaktuan si zona të prekshme nga nitratat një përqindje të territorit të tyre që varion nga 2.5% (Polonia) në 48% (Hungaria).

Deri në një studim të mëtejshëm është e vështirë të jesh i sigurt rreth përqindjes së mundshme të territorit shqiptar që do të duhet të përcaktohet si i prekshëm nga nitratat. Rrjedhimisht, përqasja e ndjekur është që të provohet të jepen njohuri për kufirin e kostove të mundshme që mund të përfshiheshin.

Shqipëria ka tre reagime të përgjithshme alternative për Direktivën e Nitratesve, si më poshtë:

- Alternativa 1: të trajtojë të gjithë territorin sikur të ishte një zonë e prekshme, në përputhje me Nenin 3(5) të Direktivës;
- Alternativa 2: të përcaktojë zona specifike të prekshme për të cilat duhet të krijohet një program/programme veprimi.
- Alternativa 3: të deklarojë që asnjë prej territoreve kombëtare nuk preket nga ndotja prej nitratesve.

Alternativa 3 mund të hidhet poshtë menjëherë. Rastet e tejkalimit të standardeve të BE-së tashmë janë raportuar pavarësisht mungesës së monitorimit sistematik të ujrave tokësore të cekëta deri tani në Shqipëri. Asnjë shtet tjetër anëtar nuk ka argumentuar në mënyrë të suksesshme që asnjë prej territoreve të tij nuk preket nga ndotja prej nitratesve, megjithëse disa shtete fillimisht e miratuan këtë qëndrim<sup>15</sup>.

Nga ana tjetër, alternativa 1 (opsioni 100 nuk duket një opsion i mirë për Shqipërinë nga perspektiva aktuale. Kur ka nitrata të përhapura nëpër territorin e një shteti anëtar, ai mund të përfaësojë një thjeshtim tërheqës dhe të zvogëlojë nevojën për (dhe kostot) e monitorimit<sup>16</sup>. Kur ky nuk është rasti, kjo do të jetë ekonomisht jo efektive meqë shumë ferma që nuk kanë asnjë ndikim të dëmshëm mjedisor (në lidhje me nitratat) do të jenë të detyruara të marrin masa të panevojshme. Zonat malore të Shqipërisë kanë të ngjarë të jenë relativisht pa nitrata dhe problemet mund të egzistojnë vetëm në zonat bregdetare bujqësore.

Kështu, supozohet që do të zbatohet alternativa 2, dmth që Shqipëria do të përcaktojë një numër zonash të prekshme të veçanta mbi bazën e një programi monitorues.

<sup>15</sup> Për shembull Irlanda argumentoi për disa vjet që ajo nuk kishte ujra të ndotura nga nitratat për qëllimet e Direktivës.

<sup>16</sup> Siç shihet më lart, 10 shtete anëtare ( të BE-25) kanë zgjedhur këtë opsion.

Për qëllim të llogaritjes së kostos, do të bëhen dy skenare alternative (të kujdesshme), konkretisht:

*Skenari 1 (i lartë): të gjitha zonat e tokës së përdorur për bujqësi do të përcaktohen si zona të prekshme,*

*Skenari 2 (i ulët): 30% e të gjithë zonave të tokës së përdorur për bujqësi do të përcaktohen si zona të prekshme.*

*Pyetja kryesore 4: Si do të trajtohen fermat me familje të vogla?*

Ne tashmë kemi parë se sektori bujqësor në Shqipëri është shumë i copëzuar dhe se ka një numër të konsiderueshëm fermash shumë të vogla (< 2 hektarë). Numri i fermave me blegtori të zhvilluar është shumë i lartë (12 njësi). Numri i përgjithshëm i njërive blegtorale të bagëtive është 14788, dhe 92% e tyre kanë më pak se 10 kafshë<sup>17</sup>.

Pyetja lind se çfarë supozimi duhet të bëhet rreth trajtimit të këtyre ndërmarrjeve shumë të vogla kur ato ndodhen në zonat e përcaktuara si të prekshme. Ka kundërshtime për vendosjen e ndonjë mase (ose të paktën mase të kushtueshme) mbi këto mikrondërmarrje. Këto kundërshtime janë ekonomike, sociale dhe praktike.

Kërkesa për të gjitha këto ferma që të marrin masa si instalimi i kapacitetit të mjaftueshëm efektiv mbajtës për mbetjet dhe plehun organik për të mbuluar kohën kur shpërndarja në tokë nuk lejohet, për shembull, do të shkaktonin kosto mjaft të mëdha për një sektor tashmë nën presion të ashpër për sigurimin e jetesës nga këto burime modeste dhe gjithashtu do të vendoste një sfidë të madhe zbatimi për shkak të numrit të madh të fermave përkatëse. Për më tepër, një sistem i sigurimit të mbështetjes financiare shtetërore për fermerët e vegjël të detyruar për të marrë masa të tilla, do të ishte i kushtueshëm gjithashtu në lidhje me kostot administrative dhe është e dyshimtë që kjo do të përfaqësonte një përdorim efektiv të parave të taksapaguesve. Ka të ngjarë që masat frenuese të kushtueshme të kërkuara nga BE-ja të jenë të panevojshme për shumë nga fermat e vogla rurale me disa kafshë që ndoshta përdorin sistemin e mbeturinave më tepër sesa një sistem më ndotës të mbetjeve.

Megjithëse Direktiva nuk parashikon shprehimisht një përjashtim të armëve të vogla nga marrja e masave të përcaktuara në programet e veprimit, formulimi i Direktivës është i tillë që për shumë masa shtetet anëtare nuk ndalohen nga caktimi i një madhësie ferme të një pragu më të ulët. Kërkesat përkatëse janë:

1. Shtetet anëtare duhet të krijojnë programme veprimi për ZP-të (Neni 5(1))

---

17 Burimi: Regjistri Statistikor Zyrtar Vjetor i nxjerrë nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, sic raportohet në Monti, D., Silvera, F. dhe Mara, E.: Gjendja aktuale e vendit: frutat, perimet dhe zooteknika-Shqipëria Projekti ADRIAFOOD i bashkëfinancuar nga BE-ja brenda Interreg III A Adriatic, 2007.

2. Rregulli i vetëm në Aneksin III (që rendit masat të cilat duhet të përfshihen në programet e veprimit) që duhet të zbatohen për të gjitha fermat është ai që trajton kufirin mbi aplikimin e plehut të kafshëve në tokë.

Përdorimi i caktimit të fazave në programet e veprimit është një instrument që mund të përdoret për të shpërndarë kostot në një periudhë më të gjatë, dmth shtetet anëtare aderuese mund të propozojnë të implementojnë vetëm masa me kosto të ulët dhe (praktikisht-)masa pa kosto në programin e parë të veprimit katër vjeçar, duke i shtyrë masat më të kushtueshme në programin e dytë. Ky veprim u ndërmor nga Lituania para aderimit të saj, për shembull, me miratimin e Komisionit Evropian<sup>18</sup>.

Çështja sesi trajtohen fermat e vogla mbivendoset me çështjen e një ristrukturimi dhe modernizimi të mundshëm të sektorit bujqësor në të ardhmen. Presionet për të arsyetuar dhe konsoliduar zotërimin e tokës bujqësore do të intensifikohen ndërsa afrohet aderimi. Nëse studimi tregon se fermat e vogla po japin kontribut të konsiderueshëm për problemin e nitrateve, atëherë kjo mund të rriste presionet për të lehtësuar dhe modernizuar sektorin bujqësor.

Për qëllim të llogaritjes së kostos aktualisht do të bëhen supozimet e mëposhtme:

- 1) **Vetëm fermat e bagëtive me më shumë se 10 njësi kafshësh<sup>19</sup> (a.u.) do të kërkohet për të marrë masa të kushtueshme (kapaciteti i përmirësuar mbajtës i plehut organik, përmirësimi i shpërndarjes së plehut organik dhe pajisjet e transportit)**
- 2) **Vetëm fermat me > 10 ha duhet të kërkohen të krijojnë plane menaxhimi për lëndët ushqyese**
- 3) **Të gjitha fermat në zonat e prekshme duhet të marrin masa të tjera, përfshirë respektimin e kufirit të shpërndarjes së azotit të plehut organik për hektar në tokë.**

### 5.1.3 Kostot e llogaritura të transpozimit ligjor

Në arritjen e anëtarësimit në BE, Shqipëria do të duhet t'i referohet një pjese të konsiderueshme të legjislacionit mjedisor, duke përfshirë një sasi

---

<sup>18</sup> Shih raportin e shkurtër të botuar nga Progami i Veprimit të Derdhjeve Bujqësore Balltike: qëndrimet e Lituanisë dhe BE-së mbi Kapitullin 22: "Mjedisi", 6 prill 2001.

<sup>19</sup> Një njësi e përbashkët matjeje për kafshët në një operacion ushqimor, llogaritet si më poshtë:

- Lopë qumështore- numri i kafshëve x 1.4
- Bagëti të trasha për mish- numri i kafshëve x 1.0
- Derra - numri i kafshëve x 0.4
- Kuaj - numri i kafshëve x 2.0
- Dele - numri i kafshëve x 0.1
- Shpendë- numri i kafshëve x 0.033

të madhe të legjislacionit të ri mbi ujin në dokumentat e tij statutorë. Kjo do të përbëjë jo vetëm legjislacionin parësor por edhe legjislacionin e nevojshëm dytësor. Ky i fundit përfshin një kod të praktikës së mirë bujqësore që konsiderohet legjislacion dytësor meqë do të jetë ligjërish detyrues për fermat që shtrihen brenda zonave të prekshme. Njëkohësisht, burimet njerëzore në dispozicion pranë Ministrive përkatëse (MMPAU, MBUMK) janë shumë të kufizuara për këtë detyrë kryesore.

Rekomandohet që të hartohet një Projekt TA i mesëm (konsulentë ndërkombëtarë për 440 ditë, konsulentë kombëtarë për 440 ditë) për të lejuar transpozimin e plotë. Ndoshta do të ishte e përshtatshme që ky aktivitet të integrohej me një projekt tjetër TA në sektorin e ujit.

Bazuar sa më sipër, kostot shtesë të transpozimit të plotë do të ishin 800,000 Euro.

#### 5.1.4 Kostot e llogaritura të zbatimit dhe detyrimit

Kostot e llogaritura të zbatimit të Direktivës tregohen në tabelat më poshtë. Tabela të ndara paraqiten për skenarin 1 (të gjitha zonat bujqësore përcaktohen si ZP) dhe skenari 2 (30% e zonave bujqësore të përcaktuara si ZP):

Tabela 6.1: Kostot e zbatimit mbi skenarin 1

Tipi i kostos	Kostot kapitale / specifike <sup>20</sup> (€000)	Kostot periodike/operuese (€000/vit)	Vërejtje
Personel shtesë: 4 persona		58	Përfshin një person shtesë në MMPAU, një në MBUMK dhe dy (persona të barazvlefshëm) në inspektoratin kompetent. Përfshin kostot sociale dhe kostot e ngjashme të punësimit: ambjentet e zyrave, ngrohja, pajisjet normale, raportimi, shpenzime të përgjithshme
Asistencë teknike	1,600		Një Projekt TA do të sigurojë mbështetje për autoritetet kompetente në aktivitetet kryesore gjatë ciklit të parë
Raportim ndaj Komisionit Evropian		10	
Rritje e	500		Rreth ndotjes nga nitrati nga

<sup>20</sup> Të gjitha kostot janë llogaritur me cmimet kostante të vitit 2008.



ndërgjegjësimit, trajnimi dhe pjesëmarrja			fermat, rreth masave në programet e veprimit, rreth kodeve të praktikës së mirë bujqësore
Zbatimi i programeve të veprimit	13,155	616	Këto janë masa që duhet të merren nga fermerët në lidhje me zhvillimin e një plani menaxhimi për lëndët ushqyese dhe rritjen e kapaciteti mbajtës të plehut organik dhe mbetjeve dhe infrastrukturën trajtuese.
<b>Totali</b>	<b>15,255</b>	<b>683</b>	

Tabela 6.2: Kostot e Zbatimit në bazë të skenarit 2

Tipi i kostos	Kosto kapitale/ specifike <sup>21</sup> (€000)	Kosto periodike/ operuese (€000/vit)	Vërejtje
Personel shtesë: 4 persona		43	Përfshin një person shtesë në MMPAU, një në MBUMK dhe një (person të barazvlefshëm) në inspektoratin kompetent. Përfshin kostot sociale dhe kostot e ngjashme të punësimit: ambjentet e zyrave, ngrohja, pajisjet normale, raportimi, shpenzime të përgjithshme.
Asistencë teknike	1,600		Një Projekt TA do të sigurojë mbështetje për autoritetet kompetente në aktivitetet kryesore gjatë ciklit të parë
Raportimi për Komisionin Evropian		10	
Rritje e ndërgjegjësimit, trajnimi dhe pjesëmarrja	350		Rreth ndotjes nga nitrati nga feramat, rreth masave në programet e veprimit, rreth kodeve të praktikës së mirë bujqësore
Zbatimi i programeve të veprimit	3,947	185	Këto janë masa që duhet të merren nga fermerët në lidhje me zhvillimin e një plani menaxhimi për lëndët ushqyese dhe rritjen e kapaciteti mbajtës të plehut organik dhe mbetjeve dhe infrastrukturën trajtuese.

21 Të gjitha kostot llogariten me cmimet kostante të vitit 2008.

<b>Totali</b>	<b>5,897</b>	<b>237</b>	

Tabelat e mësipërme përfshijnë vetëm kosto nën zero. Ka disa veprime të renditura në tabelën 2 dhe seksionin 4.4 që nuk shkaktojnë kosto të atribuueshme Direktivës së Nitratesve. Këto përfshijnë:

- Harduerin dhe softuerin për bazat e të dhënave, VGJSH, prezantimet grafike etj. Masat e marra sipas DKU për këto materiale në KBL dhe qeveritë qendrore janë të mjaftueshme;
- Masa për burime shtesë njerëzore në RNC për aktivitete në lidhje me Direktivën e Nitratesve;
- Kostot për pajisje, transport, personel dhe analiza laboratorike në lidhje me monitorimin e nevojshëm

Këto kosto përfshihen në kostot e llogaritura për Planin e Zbatimit të Direktivës Kuadër të Ujit

Kostot e përgjithshme të zbatimit logariten në kostot specifike prej 15.3 milionë Euro dhe kostot periodike prej 683,000 Euro në vit (skenari 1), ose kostot specifike prej 5.9 milionë Euro dhe kostot periodike prej 237,000 Euro (skenari 2).

Sektorët në të cilët hyjnë këto kosto më parë jepen në tabelën e mëposhtme:

Tabela 7: Sektorët në të cilët kostot e skenarit 1 hyjnë në kategorinë e parë

Sektori	Kostot kapitale/ specifike (€'000)		Kostot periodike/ operuese (€'000)		Vërejtje
	Skenari 1	Skenari 2	Skenari 1	Skenari 2	
Qeveria qendrore	2,100	1,950	68	53	
Fermat	13,155	3,947	616	185	Fermat e interesuara do të jenë ferma më të mëdha të ndodhura në ZP

Kostot specifike të qeverisë qendrore lidhen gjerësisht me koston e sigurimit të asistencës teknike të nevojshme, me sasi më të vogla që duhet të mbulojnë koston e rritjes së ndërgjegjësimit, trajnimit dhe pjesëmarrjes.

Kostot periodike i atribuohen qeverisë qendrore në lidhje me nevojën për një person shtesë (ose person të barazvlefshëm me orar të plotë) në secilën prej ministrive bujqësore për t'u kujdesur për aktivitetet në lidhje me

Direktivën e Nitrates dhe kapacitetet për inspektor shtesë për zbatimin e masave të programeve.

## 5.2 Strategjia e Financimit

Duhet bërë një dallim midis:

- kostove specifike që hyjnë në kategorinë e parë mbi qeverinë qendrore;
